



Funded by
the European Union

IPLS

institute for policy
& legal studies



OPEN SOCIETY FOUNDATION
FOR ALBANIA



Linja e Këshillimit
për Grat dhe Vajza
116 117

“Gjykata në Mbrojtje të Viktimave: Studim mbi vendimet gjyqësore në çështjet e dhunës në familje”

Periudha e monitorimit: 01.01.2025-31.09.2025



Përgatitja e raportit u realizua në kuadrin e projektit

“Enhancing Judicial Integrity and Access to Justice for Survivors of Violence in Tirana District Court”, me ndihmën dhe mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, nëpërmjet projektit “Judiciary Under Spotlight”.

Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e këtij botimi është vetëm përgjegjësi e Linjës së Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGV) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJE

HYRJE.....	5
METODOLOGJIA.....	6
KREU I	8
PERFORMANCA E GJYKATËS.....	8
I.1 PUBLICITETI I SEANCave GJYQËSORE.....	8
I.2 AKSESI I PUBLIKUT NË KALENDARIN E GJYQËVE	11
I.3 SOLEMNITETI I SEANCave GJYQËSORE.....	12
I.4 MBAJTJA E PROCESVERBALEVE TË SEANCave GJYQËSORE	12
I.5 INFORMIMI MBI VENDIMET GJYQËSORE	13
I.6 SHPALLJA DHE PUBLIKIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE	14
I.7 ANONIMIZIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE	15
I.8 LEHTËSIA E KËRKIMIT NË BAZAT E TË DHËNAVE PÛRKATËSE NGA PUBLIKU I GJERË	18
I.9 AKSES NË INFORMACIONIN PUBLIK DHE TRANSPARENCA NË GJYQËSOR.....	18
KREU II-ROLI I GJYKATËS NË ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE.....	21
II.1 PRAKTIKA E LËSHIMIT TË URDRHAVE TË MBROJTJES NGA GJYKATA.....	21
II.2 GARANCIA E PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR PËR VIKTIMAT E DHUNËS ...	22
II.3 GJYKIM I DREJTË DHE PUBLIK	23
II.4 ANALIZË E KOHEZGJATJES SË URDHËRAVE TË MBROJTJES.....	40
II.5 REAGIMI INSTITUCIONAL DHE MASAT MBROJTËSE	42
II.6 PJESËMARRJA E INSTITUCIONEVE NE PROCES.....	45
KREU III	47
PROFILI SOCIO-EKONOMIK DHE ARSIMOR I VIKTIMAVE DHE DHUNUESVE.....	47
III.1 DIMENSIONI GJINOR I DHUNËS NË FAMILJE	47
III.3 ARSIMI.....	50
III.4 STATUSI I PUNËSIMIT	52
III.5 MOSHA MESATARE.....	54
III.6 ROLI I GJENDJES FAMILJARE DHE SOCIAL-EKONOMIKE.....	56
III.7 TË MITURIT DHE FORMAT E MBROJTJES SË TYRE	56
III.8 DHUNA DHE ELEMENTËT E SAJ	59
III.9 ELEMENTË PËRNDJEKJEJE DHE DHUNA DIGJITALE	61
III.10 SHKAQET E DHUNËS (TË DEKLARUARA)	62
KREU IV	65
CËSHTJET E RRËZUARA DHE TË PUSHUARA.....	65
IV.1 CËSHTJET E RRËZUARA.....	65
IV.2 CËSHTJET E PUSHUARA	66
KONKLUZIONE	68
I. Transparenca dhe publiciteti i seancave.....	68

II. Publikimi dhe anonimizimi i vendimeve	68
III. E drejta për mbrojtje dhe ndihmë juridike	68
IV. Cilësia e vendimeve dhe arsyetimi gjyqësor	69
V. Aspektet gjinore dhe socio-demografike	70
VI. Fëmijët dhe mbrojtja e tyre	71
VII. Format, shkaqet dhe sfidat e provueshmërisë së dhunës	71
VIII. Arsyetimi i vendimeve të rrëzuara dhe pjesëmarrja e ekspertëve	72
REKOMANDIME	73
I. Transparenca dhe publiciteti i seancave	73
II. Publikimi dhe anonimizimi i vendimeve	73
III. E drejta për mbrojtje dhe ndihmë juridike	73
IV. Cilësia e vendimeve dhe arsyetimi gjyqësor	74
V. Aspektet gjinore dhe socio-demografike	74
VI. Fëmijët dhe mbrojtja e tyre	75
VII. Format, shkaqet dhe sfidat e provueshmërisë së dhunës	75
VIII. Arsyetimi i vendimeve të rrëzuara dhe pjesëmarrja e ekspertëve	76
Literatura:	77
Legjislacioni:	77
Studime:	77

HYRJE

Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje përbëjnë sfida të mëdha sociale që godasin thellë dinjitetin dhe të drejtat themelore të individëve, duke pasur pasojë serioze në shëndetin fizik dhe psikologjik të viktimave. Ndërsa legjislacioni në Shqipëri është përmirësuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit, zbatimi i efektshëm i tij mbetet një sfida, veçanërisht në nivelin lokal ku ndikimi i drejtpërdrejtë mbi jetën e viktimave është më i dukshëm.

Ky raport fokusohet në rolin kyç të sistemit gjyqësor në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të viktimave të dhunës në familje, gjatë periudhës 01.01.2025 - 31.09.2025 dhe fokusohet në performancën gjyqësore, duke theksuar tendencat, boshllëqet dhe fushat për përmirësim.

Raporti paraqet analizën monitoruese të 173 vendimeve të pranuar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, 184 vendime të rrëzuara/refuzuara dhe 12 vendime të pushuara, në kuadër të procedurave civile për mbrojtjen nga dhuna në familje për çështjet me objekt lëshimin e urdhërave të mbrojtjes (UMM/UM). Janë monitoruar dhe analizuar në mënyrë sistematike këto vendime gjyqësore, me qëllim vlerësimin e cilësisë procedurale dhe përmbajtësore të tyre, si dhe evidentimin e tendencave, sfidave dhe praktikave më të mira në zbatimin e masave mbrojtëse ndaj viktimave të dhunës familjare.

Analiza mbulon elementët kyç të profilit të palëve të përfshira, duke përfshirë aspektet gjinore, socio-ekonomike dhe arsimore të viktimave dhe dhunuesve, si dhe llojet dhe format e dhunës të evidentuara në vendimet gjyqësore. Raporti shqyrton gjithashtu masat mbrojtëse të vendosura nga gjykatat, procesin e administrimit të provave dhe mënyrën e arsyetimit të vendimeve, duke përfshirë respektimin e standardeve ligjore dhe konventave ndërkombëtare, përfshirë Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) dhe Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Në këtë kontekst, raporti synon:

- Të vlerësojë performancën e gjykatës objekt monitorimi;
- Të analizojë profilin gjinor dhe socio-ekonomik të viktimave dhe dhunuesve, në mënyrë që të evidentohen karakteristikat kryesore demografike dhe sociale;
- Të identifikojë format dhe shkaktarët kryesorë të dhunës në familje, si dhe tendencat në përfshirjen e fëmijëve dhe personave të tjerë të përfshirë në urdhrat e mbrojtjes;
- Të vlerësojë cilësinë dhe përputhshmërinë e vendimeve gjyqësore me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen nga dhuna në familje;

- Të evidentojë mangësitë në praktikën gjyqësore dhe të ofrojë rekomandime konkrete për forcimin e mekanizmave të mbrojtjes dhe zbatimit të urdhrave të mbrojtjes.

Ky monitorim i detajuar i vendimeve gjyqësore ka rëndësi të veçantë në kuadrin e përpjekjeve për avancimin e sundimit të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, duke adresuar një fenomen social dhe juridik me ndikim të thellë në sigurinë dhe mirëqenien e individëve dhe familjeve në shoqëri, sic është dhuna në familje. Ky studim nxjerr në pah sfidat e sistemit gjyqësor në trajtimin e urdhrave të mbrojtjes dhe ofron udhëzime të rëndësishme për përmirësimin e zbatimit dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.

METODOLOGJIA

Në kuadër të këtij raporti, u zbatua një monitorim i strukturuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me fokus në çështjet e dhunës në familje. Monitorimi u përqendrua në tregues kyç si: cilësia e ndihmës ligjore, qasja në drejtësi, dhe respektimi i afateve procedurale. Të dhënat u mblodhën gjatë një periudhe nëntë mujore, përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë dhe analizës së dokumentacionit gjyqësor.

Pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave, u krye një analizë krahasuese me standardet e BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Gjetjet u sintetizuan në një raport gjithëpërfshirës, i cili përmban tendencat kryesore, boshllëqet sistemike, si dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e trajtimit gjyqësor të rasteve të dhunës në familje.

Në kuadër të këtij monitorimi janë përzgjedhur dhe analizuar në mënyrë sistematike 173 vendime të gjykatave të lëshuara në çështje civile me objekt lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Procesi i mbledhjes dhe analizës së të dhënave u realizua duke marrë vendimet nga arkivat e gjykatës duke përfshirë një periudhë kohore të konsiderueshme (nëntë mujore), për të siguruar një pasqyrë sa më përfaqësuese të praktikës gjyqësore. Janë përfshirë vetëm vendimet që trajtojnë kërkesat për urdhra mbrojtjeje në procedura civile, duke përjashtuar çështjet penale. Të dhënat janë analizuar në disa dimensione kryesore, duke përfshirë profilin gjinor dhe socio-ekonomik të palëve, llojet dhe format e dhunës, masat mbrojtëse të vendosura, si dhe aspektet procedurale dhe ligjore të vendimmarrjes. Për këtë qëllim janë përdorur metoda statistikore për përmbledhjen e të dhënave numerike, ndërsa për vlerësimin e arsyeve dhe përmbajtjes së vendimeve janë aplikuar metoda kualitative, me fokus në përputhshmërinë e tyre me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare.

Kjo qasje metodologjike siguron një pasqyrë të qartë dhe të besueshme të praktikës gjyqësore në fushën e mbrojtjes nga dhuna në familje, duke mundësuar nxjerrjen e

rekomandimeve të informuara për përmirësimin e mekanizmave ligjorë dhe mbrojtës.

Monitorimi synon të vlerësojë nëse sistemi gjyqësor funksionon në përputhje me legjislacionin që rregullon mbrojtjen nga dhuna në familje. Një qëllim tjetër i rëndësishëm është evidentimi i problematikave që lidhen me kuadrin ligjor dhe me zbatimin praktik të tij nga institucionet gjyqësore.

Raporti synon gjithashtu të analizojë praktikën gjyqësore në zbatimin e ligjeve dhe standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të grave, viktimat të dhunës në familje. Përmes kësaj analize, synohet të vlerësohet niveli i aksesit në drejtësi dhe shkalla e ofrimit të ndihmës dhe mbështetjes për viktimat gjatë procedurave gjyqësore, si në fushën civile, ashtu edhe në atë penale.

Raporti sjell një element shumë të rëndësishëm pasi analizon performacën e Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nëpërmjet një analize shteruese të standarteve të performancës si publiciteti i seancave gjyqësore, aksesit i publikut në kalendarin e gjyqeve, solemniteti i seancave gjyqësore, mbajtja e procesverbaleve të seancave gjyqësore, shpallja dhe publikimi i vendimeve gjyqësore etj. Kjo analizë është realizuar duke u mbështetur në materialet burimore të hartuara nga Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), përkatësisht në guidat e monitorimit, të cilat ofrojnë kornizën metodologjike dhe udhëzimet praktike për vlerësimin dhe monitorimin e proceseve që lidhen me fushën përkatëse. Këto dokumente kanë shërbyer si bazë kryesore për strukturimin e qasjes analitike, mbledhjen e të dhënave dhe interpretimin e rezultateve.

KREU I

PERFORMANCA E GJYKATËS

I.1 PUBLICITETI I SEANCave GJYQËSORE

Ky raport analizon zbatimin e standardit të publicitetit të seancave gjyqësore në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm sic është Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke u fokusuar te treguesit e performancës dhe respektimi i kërkesave ligjore si neni 26 i Kodit të Procedurës Civile ku parashikohet se: *“Seancat gjyqësore janë të hapura, përveç kur parashikohet ndryshe sipas këtij Kodi. Gjykata mund të mos lejojë pjesëmarrjen e medias, kur çmon se nuk është në dobi të gjyimit. Në çdo rast vendimi përfundimtar i gjykatës shpallet publikisht”*.

Publiciteti i seancave gjyqësore përbën një element thelbësor të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe është i garantuar nga ligjet procedurale në Shqipëri. Seancat publike sigurojnë që gjykimet të zhvillohen me transparencë, duke ruajtur besimin e publikut në drejtësi dhe duke garantuar trajtim të barabartë për palët. E drejta për një proces të rregullt ligjor, të zhvilluar në mënyrë publike, të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e paanshme, e pavarur dhe e caktuar me ligj, është një nga të drejtat më të rëndësishme të garantuara në Republikën e Shqipërisë, përmes nenit 42, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Kjo e drejtë, e përbërë nga disa elemente, detajohet në ligjet procedurale, sidomos në kodet e procedurave penale dhe civile, në ligje të natyrave administrative, si dhe në jo pak akte nënligjore normative dhe kolektive.

Nga monitorimi rezulton se në ambientet e gjykatës janë vendosur kompjuterë të vegjël (kioska elektronike), përmes të cilëve qytetarët mund të kërkojnë dhe të aksesojnë informacionin publik mbi orën dhe datën e zhvillimit të seancave gjyqësore. Këto pajisje mundësojnë akses të drejtpërdrejtë dhe të përditësuar në të dhënat përkatëse, duke lehtësuar transparencën dhe orientimin e publikut brenda institucionit.

Thirrja e seancave bëhet në mënyrë publike nga sekretari gjyqësor, duke siguruar që palët, avokatët dhe çdo qytetar i interesuar të informohen në kohë. Seancat gjyqësore zhvillohen me dyer të hapura, duke lejuar pjesëmarrjen e publikut dhe medias, ndërsa faqja online e gjykatës përmban një kalendar elektronik ku publikohet orari dhe data e seancave përkatëse.

Publiciteti i seancave gjyqësore rregullohet edhe bazuar në vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor *“Për miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”*. Marrëdhënia e gjykatës me

publikun dhe median bazohet në parimet e aksesit të barabartë në gjykata, karakterit publik të procesit gjyqësor, hapjes maksimale të veprimtarisë gjyqësore ndaj shoqërisë përmes komunikimit me publikun, së drejtës së informimit, mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit si dhe prezumimit të pafajësisë.

Seancat gjyqësore publike janë të hapura për publikun dhe median. Përfaqësuesit e medias mund të ndjekin procesin gjyqësor pa bërë komente dhe brenda rregullave që diktohen nga gjyqtari/kryesuesi i trupit gjykues për zhvillimin e gjykimit të drejtë. Përfaqësuesi i medias, gjatë seancës, lejohet të raportojë përmes pajisjeve telefonike dhe/ose, kompjuterike dhe të dërgojë mesazhe të shkruara përmes tyre. Në çdo rast këto pajisje duhet të përdoren pa zë.

Gjyqtari/kryesuesi i trupit gjykues me urdhër mund të kufizojë ose të ndalojë përdorimin e pajisjeve telefonike dhe/ose kompjuterike apo pajisje të tjera gjatë seancës nëse përdorimi i tyre pengon administrimin e duhur të drejtësisë ose rendin dhe rregullin e procesit gjyqësor.

Seancat gjyqësore mund të regjistrohen dhe transmetohen në media me kërkesë të mediave ose me nismën e gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues. Në çdo rast, regjistrimi dhe transmetimi i seancës, tërësisht ose pjesërisht, bëhet vetëm kur nuk bie ndesh me rregullat e procesit të rregullt ligjor.

Media elektronike mund të regjistrojë dhe transmetojë, tërësisht ose pjesërisht, me urdhër të gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues, i cili vendos për çështjen objekt gjykimi. Çdo regjistrim tjetër është i ndaluar.

Kërkesa për pjesëmarrje i paraqitet nëpunësit për marrëdhëniet me publikun dhe median jo më vonë se njëzet e katër orë para orës së deklaruar për fillimin e seancës gjyqësore.

Gjyqtari/ kryesuesi i trupit gjykues ka të drejtën të:

- A. lejojë ose të ndalojë regjistrimin dhe transmetimin e plotë të seancës;
- B. lejojë ose ndalojë regjistrimin e pjesshëm të seancës;
- C. ndalojë transmetimin e pamjeve specifike gjatë një seance dëgjimore që ishte lejuar më parë të regjistrohej.

Kërkesa pranohet ose refuzohet plotësisht ose pjesërisht vetëm në çelje të seancës gjyqësore, kur të pranishëm në sallë janë edhe përfaqësuesit e medias që bën kërkesën. Kjo pjesë e seancës është e regjistrueshme dhe transmetohet pa asnjë kufizim.

Kërkesa mund të refuzohet vetëm për këto arsye:

- A. Seanca gjyqësore zhvillohet me dyer të mbyllura.
- B. Kur një nga subjektet në gjykim nuk dëshiron të regjistrohet seanca. Ky rregull nuk vlen për prokurorin dhe avokatin.
- C. Çmohet nga gjyqtari/kryesuesi i trupit gjykues se prania e kamerave ndikon ecurinë e procesit të rregullt gjyqësor.

Për të siguruar rendin e duhur të procesit, gjykata mund të vendosë që t'i lejohet akses në sallë një numri të kufizuar ekipesh me kamera dhe të përcaktojë si kusht që ata të jenë pjesë në një skemë shpërndarjeje tek të tjerët që nuk kanë akses. Kamerat vendosen gjithmonë në fund të sallës dhe në mënyrë statike. Ndalohet përdorimi i tyre në mënyrë të lëvizshme.

Kur seanca gjyqësore regjistrohet me kamera nga vetë gjykata, kamerat e medias elektronike nuk lejohen të filmojnë. Në këtë rast, shërbimi i marrëdhënieve me median dhe publikun nën drejtimin e gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues, shpërndan pamjet filmike dhe/ose audio nga seanca, ose lejon transmetimin e plotë të saj nga mediat të vendosura nga një mjedis i posaçëm jashtë sallës së gjyqit që administrohet nga ky shërbim.

Faqja zyrtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (www.gjykatatirana.gov.al) luan një rol kyç në garantimin e transparencës ndaj publikut. Rezulton se:

- Gjykata ka miratuar Programin e Transparencës, i cili përcakton se cilin informacion do ta bëjë publik pa kërkesë, në ç'mënyrë dhe në çfarë afatesh kohore.
- Në faqen e internetit, ekziston një skemë e publikimit që pasqyron menutë dhe strukturën e faqes ku gjenden dokumentet dhe informacionet publike. Kjo skemë bën që dokumentet të jenë lehtë të kërkueshme dhe të gjetshme për çdo përdorues.
- Dokumentet që publikohen përfshijnë: ligjet dhe aktet nënligjore, manualët dhe aktet normative relevante për gjykatën; informacion për strukturën organizative (organizimi, kompetencat), procedurat për të bërë kërkesë për informim dhe procedurat e ankimit; kontaktet e autoritetit, orari i punës, dhe të dhëna tjera që lidhen me funksionimin institucional.
- Faqja është dizajnuar që informacioni të jetë i qasshëm pa nevojë për kërkesë të veçantë, do të thotë që qytetarët mund të vizitojnë faqen dhe të gjejnë informacionet që i duhen drejtpërdrejtë.
- Transparenca nuk është vetëm për dokumente statike. Gjykata garanton që dokumentet e publikuara të jenë të përditësuara sa herë bëhen ndryshime, si në përmbajtje po ashtu edhe në formë.

Në bazë të këtyre të dhënave, mund të thuhet se faqja online e Gjykatës së Tiranës nuk është thjesht një platformë njoftuese, por një mjet aktiv për transparencë, ajo lehtëson aksesin publik në informacionet e gjykatës, minimizon barrierat e komunikimit, dhe përmirëson përgjegjshmërinë institucionale.

Nga analiza rezulton se standardi i performancës mbi publicitetin e seancave gjyqësore është i plotësuar. Të gjithë treguesit janë respektuar në praktikë: informacioni afishohet në gjykatë, thirrja bëhet publikisht, seancat zhvillohen hapur dhe faqja online garanton transparencë. Kjo praktikë rrit besueshmërinë e publikut tek sistemi gjyqësor, promovon parimin e drejtësisë së hapur dhe përmbush kërkesat ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

I.2 AKSESI I PUBLIKUT NË KALENDARIN E GJYQEVE

Publiku ka të drejtë të marrë informacion mbi listat e seancave gjyqësore dhe gjykatat janë të detyruara të vendosin këtë informacion jo vetëm në ambientet e tyre fizike, por edhe në faqet zyrtare të internetit. Përgjegjësia për përgatitjen dhe publikimin e listave të gjyqeve u takon zyrave të marrëdhënieve me publikun pranë çdo gjykate, të cilat kanë detyrimin të sigurojnë që kalendarin e gjykimeve të jetë i qashtë për qytetarët.

Këndi i afishimit të listave të gjyqeve në ambientet e gjykatës duhet të jetë i aksesueshëm për qytetarët dhe i vendosur në një vend të dukshëm, duke ofruar informacion të përditësuar mbi datën, orën dhe sallën ku zhvillohen seancat. Gjykata ka një person të caktuar për marrëdhëniet me publikun, i cili është përgjegjës për dhënien e informacionit, asistimin e qytetarëve dhe përditësimin e listave të afishuara. Në faqen online të gjykatës publikohet informacion i detajuar mbi orarin dhe datën e zhvillimit të seancave, si dhe udhëzime mbi mënyrën e aksesimit të gjykatës, qoftë fizikisht në ambientet e saj, qoftë nëpërmjet shërbimeve elektronike.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka në faqen e saj zyrtare një seksion që quhet “Kalendarin e seancave” (Këndi Informativ) që lejon publikun të shohë seancat gjyqësore, sipas gjyqtarit, sipas datave dhe sipas kategorive të çështjeve.

Oraret e seancave gjyqësore publikohen automatikisht dhe përdoruesit mund të shohin seancat e datave të ardhshme, si dhe ato që janë zhvilluar më parë.

Seksioni ofron mundësi kërkimi sipas kategorive të çështjeve dhe sipas gjyqtarëve.

Nga analiza rezulton se standardi i performancës për aksesin e publikut në kalendarin e gjyqeve është i përmbushur. Qytetarët kanë akses të plotë, si në formë fizike përmes tabelave elektronike të afishuara në gjykatë, ashtu edhe në formë digjitale

përmes faqes online të gjykatës. Për më tepër, ekzistenca e një personi përgjegjës për marrëdhëniet me publikun garanton që komunikimi të jetë i vazhdueshëm dhe efikas. Kjo rrit transparencën e sistemit gjyqësor dhe forcon besimin e publikut tek gjykatat.

I.3 SOLEMNITETI I SEANCAVE GJYQËSORE

Solemniteti i seancave gjyqësore është një element i rëndësishëm i së drejtës për proces të rregullt. Zhvillimi i seancave në sallat e posaçme të gjykimit siguron hapësirë të mjaftueshme për pjesëmarrjen e publikut dhe medias, shmang kontaktet e padëshiruara të palëve me gjyqtarët dhe ruan respektin që qytetarët duhet të kenë ndaj gjykatës si institucion i drejtësisë. Kur seancat zhvillohen në zyra gjyqtarësh, humbet pjesërisht solemniteti i procesit, rrezikohet transparenca dhe krijohet perceptimi i mungesës së barazisë.

Seancat gjyqësore publike nuk zhvillohen gjithmonë në sallat e gjyqit. Për shkak të ngarkesës dhe mungesës së infrastrukturës, shpesh ato mbahen në zyrat e gjyqtarëve. Kjo praktikë kufizon hapësirën për publikun dhe median dhe e vështirëson pjesëmarrjen e personave të interesuar. Megjithatë, në rastet kur ato zhvillohen në sallat e gjykimit, garantohen kushte më të mira për solemnitet dhe transparenca. Personat e interesuar dhe mediat lejohen të ndjekin seancat, por mundësitë e tyre varen nga mjedisi ku ato zhvillohen. Nga ana tjetër, faqja online e gjykatës ofron informacion mbi orarin dhe datën e seancave, si dhe udhëzime mbi procedurat për pjesëmarrjen e medias në proces, gjë që ndihmon në rritjen e transparencës.

Nga analiza rezulton se standardi i performancës për solemnitetin e seancave gjyqësore nuk është plotësisht i përmbushur. Ndërsa ekziston një vullnet për transparenca dhe informacioni publikohet në faqet zyrtare të gjykatave, zhvillimi i seancave jo gjithmonë në sallat e gjyqit çënon perceptimin e seriozitetit të procesit dhe kufizon aksesin e publikut. Kjo tregon nevojën për përmirësim të infrastrukturës gjyqësore dhe garantimin që seancat të zhvillohen në mjediset e posaçme të gjykimit, si një mënyrë për të forcuar respektin dhe besueshmërinë ndaj sistemit të drejtësisë.

I.4 MBAJTJA E PROCESVERBALEVE TË SEANCAVE GJYQËSORE

Mbajtja e procesverbaleve nëpërmjet regjistrimit digjital audio ose audioviziv është një detyrim ligjor i parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile. Ky sistem siguron dokumentim të saktë të seancës gjyqësore, rrit transparencën dhe përmirëson

administrimin e gjykatave. Sipas nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile, procesverbali duhet të mbahet për çdo seancë dhe për çdo veprim tjetër procedural gjyqësor që zhvillohet jashtë saj. Në mungesë të regjistrimit audio, procesverbali përgatitet me shkrim, por në mënyrë të plotë dhe të saktë. Mosmbajtja ose pavlefshmëria e procesverbalit sjell prishjen e vendimit nga gjykata e apelit. Gjithashtu, transkriptimi i procesverbalit ofrohet në rastet kur kërkohet nga gjykatësit, palët ose persona të tjerë të interesuar, pas pagesës së tarifave të përcaktuara.

Në shumicën e rasteve procesverbalet mbahen përmes regjistrimit audio të seancave gjyqësore, duke përmbushur kërkesën ligjore për dokumentim të saktë. Megjithatë, ka raste kur për shkak të mungesës së pajisjeve funksionale ose të ndërprerjeve teknike për shkak të zhvillimit të seancave gjyqësore në zyrat e gjyqtarëve, procesverbali mbahet vetëm në formë të shkruar nga sekretari gjyqësor. Kjo krijon diferenca në nivelin e saktësisë dhe mund të ndikojë tek transparenca.

Personat e interesuar lejohen të kërkojnë kopje të transkriptuara të procesverbaleve, në përputhje me ligjin. Megjithatë, praktika tregon se ky proces shpesh vonohet për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe kostove shtesë që lidhen me përgatitjen e transkripteve.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ofron në faqen e saj zyrtare formularë tip për kopje të procesverbaleve gjyqësore audio.

Standardi i performancës për mbajtjen e procesverbaleve është i parashikuar qartë në ligj, por zbatimi praktik është i pjesshëm. Përdorimi i regjistrimit audio garanton saktësi dhe transparencë më të lartë, megjithatë mungesat teknike dhe praktika e procesverbaleve të shkruara tregojnë nevojën për përmirësim të infrastrukturës dhe standardizimit të procedurave.

I.5 INFORMIMI MBI VENDIMET GJYQËSORE

Institucionet gjyqësore kanë një rol thelbësor në garantimin e transparencës dhe aksesit të publikut në vendimet gjyqësore. Standardi i performancës kërkon që gjykatat të krijojnë arkiva elektronikë, të cilët sigurojnë ruajtjen dhe përdorimin e dokumentacionit elektronik. Përmes këtyre arkivave, shërbimi i arkivit gjyqësor bëhet substancial, efektiv dhe i përshtatur me nevojat e publikut.

Arkivat elektronike përfaqësojnë një komponent të rëndësishëm të modernizimit të sistemit të drejtësisë, pasi mundësojnë qasje më të shpejtë dhe të strukturuar në të dhënat gjyqësore, si për stafin gjyqësor, ashtu edhe për qytetarët, avokatët dhe palët e interesuara. Kjo qasje përmirëson cilësinë e shërbimit, rrit transparencën institucionale dhe kontribuon në forcimin e besimit të publikut ndaj sistemit të drejtësisë.

Megjithatë, pavarësisht përparimeve të shënuara, procesi i digjitalizimit të arkivave gjyqësore në gjykatën objekt monitorimi mbetet ende në zhvillim. Si rrjedhojë, në disa raste, qasja në dokumentacionin e digjitalizuar është e kufizuar, ndërsa shërbimi i arkivit nuk i përgjigjet ende plotësisht nevojave të qytetarëve për akses të shpejtë dhe efikas.

Për të përmbushur standardet e transparencës dhe llogaridhënies, është thelbësore që gjykatat të përshpejtojnë përpjekjet për transformimin digjital të shërbimeve të tyre, duke siguruar funksionalitet të plotë të arkivave elektronike, integrim të sistemeve me platforma kombëtare të drejtësisë, dhe trajnime të vazhdueshme për stafin që menaxhon dokumentacionin elektronik.

I.6 SHPALLJA DHE PUBLIKIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE

Publikimi i vendimeve gjyqësore, si një detyrim ligjor dhe një garanci themelore për transparencën e drejtësisë, mbetet një sfidë në praktikën gjyqësore. Standardi i performancës kërkon që vendimet të jepen në emër të Republikës së Shqipërisë, të jenë publike dhe të aksesueshme për qytetarët. Megjithatë, situata praktike tregon se publikimi i vendimeve online shpesh nuk ndodh. Shkaku kryesor lidhet me procesin e anonimizimit të vendimeve, i cili ka si qëllim mbrojtjen e të dhënave personale të palëve në gjykim.

Ky parim është i sanksionuar në një sërë aktesh ligjore dhe strategjike, përfshirë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin për Organizimin e Sistemit Gjyqësor, si dhe dokumente të hartuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe institucionet ndërkombëtare që monitorojnë sistemin e drejtësisë. Në mënyrë të veçantë, Standardi i Performancës për Sistemin Gjyqësor kërkon që çdo vendim të jetë jo vetëm i arsyetuar dhe i ligjshëm, por edhe i publikuar në mënyrë transparente në faqet zyrtare të gjykatave dhe në një regjistër elektronik të vendimeve gjyqësore.

Megjithatë, zbatimi i këtij detyrimi në praktikë lë ende shumë për të dëshiruar. Për shkak të mungesës së burimeve teknike dhe njerëzore, gjykata objekt monitorimi nuk arrin të përmbush këtë detyrim dhe për pasojë nuk i publikon vendimet në mënyrë publike.

Shkaku kryesor lidhet me procesin e anonimizimit të vendimeve, i cili është një hap i domosdoshëm për të mbrojtur të dhënat personale dhe sensitive të palëve të përfshira në procesin gjyqësor, siç janë emrat e personave, adresat, të dhënat mjekësore apo informacione të tjera private.

Në mungesë të burimeve të mjaftueshme teknike dhe njerëzore, gjykata përballet me vështirësi serioze për të përmbushur këtë kërkesë. Procesi i anonimizimit, që

duhet të realizohet para çdo publikimi, shpesh kërkon kohë dhe burime që nuk janë të disponueshme në kapacitetet aktuale të administratës gjyqësore. Si rrjedhojë, në vend që të zbatohet një publikim i pjesshëm me masat e duhura të mbrojtjes së të dhënave, gjykata nuk i publikon vendimet, duke shmangur plotësisht rrezikun e ekspozimit të të dhënave personale, por njëkohësisht duke cënuar parimin e transparencës.

Kjo situatë krijon një boshllëk të theksuar në qasjen e publikut dhe medias ndaj vendimmarrjes gjyqësore, duke pamundësuar monitorimin e pavarësisë, paanësisë dhe cilësisë së drejtësisë që ushtrohet në emër të shtetit dhe qytetarëve. Mungesa e publikimit gjithashtu ndikon negativisht në ndërtimin e një jurisprudence të qasshme, të sistemuar dhe të dobishme për profesionistët e drejtësisë, studentët dhe palët e interesuara.

I.7 ANONIMIZIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE

Në realitetin digjital të sotëm, mbrojtja e të dhënave personale përbën një nga sfidat më të mëdha, pasi individët, organizatat dhe institucionet lëvizin në një terren të ndjeshëm ku përfitimet e teknologjisë shpesh vihen në konflikt me mbrojtjen e privatësisë. Brenda këtij konteksti, një element i rëndësishëm është anonimizimi i vendimeve gjyqësore, i cili synon të mbrojë të drejtat e individëve pa cenuar transparencën e sistemit gjyqësor.

Anonimizimi i vendimeve gjyqësore nënkupton procesin e heqjes ose fshehjes së të dhënave të ndjeshme dhe identifikuese nga tekstet e vendimeve gjyqësore përpara se ato të bëhen publike. Këto të dhëna zakonisht përfshijnë emra, adresa, numra personale, llogari financiare dhe çdo informacion tjetër që mund të çojë në identifikimin e palëve të përfshira.

Ky proces ka si qëllim të krijojë një ekuilibër të drejtë midis dy kërkesave themelore:

- ruajtjes së privatësisë dhe konfidencialitetit të individëve,
- dhe garantimit të transparencës së drejtësisë për publikun.

Përmes anonimizimit, gjykatat arrijnë të publikojnë vendime që shërbejnë si burim informacioni, praktike dhe jurisprudence, pa vënë në rrezik të dhënat personale të qytetarëve.

Rëndësia e këtij procesi vërehet në disa dimensione:

- Mbrojtja e privatësisë: individët nuk ekspozohen ndaj rrezikut të stigmatizimit ose abuzimit me të dhënat e tyre.
- Promovimi i paanshmërisë: duke shmangur njohjen e identitetit apo prejardhjes, minimizohen paragjykimet që mund të ndikojnë në interpretimin e çështjes.
- Rritja e besimit në drejtësi: transparenca e kontrolluar ndihmon qytetarët të kenë më shumë besim tek sistemi gjyqësor, pasi u ofrohet qasje në aktgjykime pa cenuar privatësinë.

Megjithatë, praktikat nuk janë të njëjta në të gjitha vendet. Legjislacionet dhe politikat gjyqësore ndryshojnë nga shteti në shtet: disa theksojnë më shumë transparencën absolute, ndërsa të tjerë i japin prioritet mbrojtjes së të dhënave personale. Kjo tregon se nuk ekziston një standard universal, por gjithsesi anonimizimi shihet gjerësisht si një mjet i domosdoshëm për të garantuar një drejtësi moderne, të hapur dhe njëkohësisht të drejtë.

Sipas nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 33/2022, datë 31.03.2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, “anemizimi” është procesi “i ndryshimit të dokumenteve në mënyrë që dokumenti të mos lidhet me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm, ose procesi i bërjes së të dhënave personale anonime, në mënyrë që subjekti i të dhënave të mos jetë më i identifikueshëm”.

Sipas udhëzimit nr. 4059/2, datë 07.06.2016 “Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave”, të Ministrit të Drejtësisë, ky i fundit ka udhëzuar që vendimet gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe të apeleve, përpara se, të hidhen në portalin elektronik të vendimeve, duhet të anonimizohen, duke u fshirë:

- I. gjeneralitetet e palëve, personave të tretë, dëshmitarëve dhe ekspertëve;
- II. të dhënat që sjellin cenim të privatësisë së palëve në gjykim, si adresa, targa e makinës, numrat e telefonit, si dhe “*çdo element tjetër i cili identifikon subjektin e të dhënave*”;
- III. gjeneralitetet e ortakëve ose aksionarëve, përqindjet e aksioneve ose të kuotave që
- IV. zotërojnë, numrat e llogarive bankare, shumat monetare dhe sekretet tregtare;
- V. të dhënat e lidhura me të tretët, “nga të cilat mund të zbulohet, edhe indirekt, identiteti i të miturit, në rastet kur ky i fundit është palë në gjykim”; si dhe
- VI. “*çdo e dhënë tjetër që cenon dinjitetin dhe jetën private të palëve, ose të personave të tjerë të lidhur me çështjen gjyqësore*”.

Anonimizimi i vendimeve gjyqësore në Shqipëri është një proces në zhvillim, ligjërish i detyrueshëm, por praktikisht ende jo i standardizuar dhe shpesh i

pasaktë. Qëllimi është të sigurohet transparencë pa cenuar privatësinë, por për këtë nevojiten teknologji, trajnime dhe një metodologji e përbashkët për të gjitha gjykatat.

Një problematikë tjetër që haset në anonimizimin e të dhënave në mënyrë automatike nga sistemi ICMS është se, ai identifikon p.sh. emrin e palës, por në brendësi të vendimit, emri i palës ndryshon për shkak të lakimit, apo rasave. Ndaj, sistemi e ka të vështirë ta identifikojë dhe kjo e dhënë del jo e anonimizuar.

Palët në proces mund të marrin nga gjykata kodin e anonimizimit të çështjes së tyre gjyqësore për të shkarkuar informacionin e pa anonimizuar. Kodi i anonimizimit është një kod unik që lejon akses në dokumente gjyqësore të paanonimizuara, pra me të dhëna personale. Ky kod i jepet vetëm palëve në proces ose përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe nuk është i disponueshëm për qytetarët e thjeshtë pa një arsye ligjore dhe pa miratim zyrtar. Për ta marrë, duhet të kontaktosh gjykatën përkatëse, të kërkesësh përmes sistemit elektronik gjyqësor nëse je i regjistruar, ose të paraqesësh një kërkesë zyrtare nëse ke interes të ligjshëm. Nëse nuk je palë në çështje, informacioni i paanonimizuar nuk është i aksesueshëm.

Nga pikëpamja e treguesve të realizimit, rezulton se publikimi online i vendimeve gjyqësore nuk është i garantuar dhe nuk realizohet në mënyrë të rregullt. Anonimizimi mbetet një pengesë e madhe, pasi procesi shpesh është i gjatë dhe i pasigurt, duke bërë që gjykatat të mos i shpallin vendimet publikisht. Në këtë mënyrë, edhe pse ligjërisht qytetarët trajtohen në mënyrë të barabartë, në praktikë ata nuk kanë qasje efektive në informacion, çka rrit ndjesinë e mbylljes së sistemit gjyqësor.

Standardi i performancës për shpalljen dhe publikimin e vendimeve gjyqësore nuk është i realizuar plotësisht. Mungesa e kapaciteteve për anonimizim ka sjellë si pasojë mospublikimin e vendimeve, duke kufizuar transparencën dhe duke cenuar besimin e publikut tek gjykatat. Përmirësimi i këtij faktori kërkon ndërhyrje institucionale, përmes investimeve në teknologji dhe rritjes së kapaciteteve administrative për të garantuar anonimizim të shpejtë dhe të saktë të vendimeve.

Për të adresuar këtë problem, është e domosdoshme që:

- Të investohet në zhvillimin e kapaciteteve teknologjike, përfshirë zbatimin e sistemeve automatike të anonimizimit (bazuar në inteligjencën artificiale ose mjete të tjera të asistuara).
- Të rritet numri dhe trajnimi i stafit përgjegjës për anonimizimin dhe publikimin e vendimeve.

- Këshilli i Lartë Gjyqësor të vendosë objektiva të qarta dhe të monitorueshme për përmbushjen e këtij detyrimi nga çdo gjykatë.
- Të ndërtohet një Regjistër i Unifikuar Elektronik i Vendimeve Gjyqësore, i integruar me sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore (ICMIS), që të garantojë publikim në kohë reale dhe të strukturuar.

Kjo situatë krijon një mungesë të dukshme transparence dhe cenon të drejtën e publikut për t'u informuar mbi drejtësinë që ushtrohet në emër të tij.

I.8 LEHTËSIA E KËRKIMIT NË BAZAT E TË DHËNAVE PÛRKATËSE NGA PUBLIKU I GJERË

Akresi i publikut në çështjet gjyqësore kërkon që informacioni të jetë i plotë, i saktë dhe i përditësuar. Standardi i performancës parashikon që çdo gjykatë të ketë një arkiv elektronik funksional, ku qytetari mund të marrë në kohë informacion mbi çështjet në gjykim, si dhe të aksesojë vendimet gjyqësore. Gjykatat gjithashtu duhet të garantojnë që çdo person të ketë akses të barabartë në informacion dhe dokumentacionin gjyqësor, si dhe mbrojtje të të drejtave ligjore, pa diskriminim në proceset gjyqësore. Për këtë qëllim, bazat e të dhënave duhet të jenë të digjitalizuara dhe të aksesueshme për publikun e gjerë.

Nga vlerësimi i treguesve të realizimit rezulton se:

- Nuk ka publikim të plotë online të çështjeve gjyqësore në proces, dhe vendimet nuk janë të disponueshme për publikun për shkak të mungesës së anonimizimit.
- Arkivat gjyqësore janë pjesërisht digjitalizuar, por mungesa e standardizimit dhe kapaciteteve teknike e bën kërkimin jo të lehtë.

Standardi i performancës mbi lehtësinë e kërkimit në bazat e të dhënave për publikun e gjerë nuk është i plotësisht i realizuar. Mungesa e publikimit të vendimeve dhe e informacionit të përditësuar, si dhe digjitalizimi i pjesshëm i arkivave, kufizon aksesin efektiv të qytetarëve. Përmirësimi i këtij faktori kërkon investime në teknologji, digjitalizim të plotë, përditësim të vazhdueshëm të informacionit dhe zhvillim të programeve edukative për publikun e gjerë.

I.9 AKSES NË INFORMACIONIN PUBLIK DHE TRANSPARENCA NË GJYQËSOR

Standardi i performancës për qasjen në informacionin publik dhe transparencën në gjyqësor kërkon që gjykatat të ofrojnë informacion të plotë, të saktë dhe të përditësuar për qytetarët mbi procedurat gjyqësore, vendimet, tarifat dhe të

drejtat e palëve në proces. Kjo përfshin mundësinë e aksesit në gjykatë dhe procedura, si fizikisht ashtu edhe online. Faqet zyrtare të gjykatave duhet të jenë funksionale gjatë gjithë kohës, të përditësuara dhe të plotësojnë nevojat e publikut për informacion mbi ligjin material dhe procedural, afatet procedurale, tarifën dhe shpenzimet gjyqësore. Gjykatat duhet gjithashtu të ofrojnë shërbime që ndihmojnë qytetarët të kuptojnë rolin e gjykatës dhe mënyrën e vendosjes së marrëdhënieve me të, përfshirë sportelet e informacionit, nëpunësit e dedikuar dhe udhëzuesit tip, duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë.

Nga vlerësimi i treguesve të realizimit rezulton se faqja zyrtare është funksionale, por nuk ofron gjithmonë informacion të plotë dhe të përditësuar mbi çështjet gjyqësore dhe vendimet. Sportelet e informacionit dhe nëpunësit e dedikuar janë të pranishëm në gjykatë. Procedurat për qasje në informacion publik ekzistojnë. Informacioni mbi ekspertët, avokatët dhe ndërmjetësuesit publikohet në mënyrë transparente. Edhe formularët e aplikimit mund të shkarkohen nga faqja e gjykatës.

1

Kushtet në ambientet e gjykatës, përfshirë dhomat e pritjes, nuk plotësojnë standardet e pranueshmërisë për përdoruesit. Hapësirat e dedikuara për pritje janë të kufizuara dhe shpesh jo të rehatshme, ndërsa mungon privatësia e nevojshme për takime konfidenciale midis palëve dhe avokatëve.

Në ambientet e gjykatës nuk mundësohet ndarja fizike e palëve në procesin gjyqësor, gjë që krijon mungesë privatësie dhe mund të ndikojë negativisht në rrjedhën e seancave. Kjo situatë mund të shkaktojë tensione dhe shqetësime për palët, veçanërisht në raste ku ekziston një konflikt i theksuar apo kur trajtohen çështje delikate. Mungesa e ndarjes fizike pengon gjithashtu respektimin e parimit të barazisë dhe sigurisë gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore.

Gjithashtu, mungesa e një hapësire adekuate për parkim para ose pranë godinës së gjykatës përbën një pengesë shtesë për qytetarët që kërkojnë akses në shërbimet gjyqësore. Këto kushte të papërshtatshme ndikojnë negativisht në përvojën e përdoruesve dhe në qasjen efektive ndaj drejtësisë.

Qasja për personat me aftësi të kufizuara dhe për komunitetet e pakicave nuk është e garantuar plotësisht. Qasja në sistemin gjyqësor për personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet e pakicave nuk është ende e garantuar në mënyrë të plotë dhe efektive. Në shumë raste, infrastruktura fizike e gjykatave nuk plotëson standardet e nevojshme për të siguruar lëvizjen dhe pjesëmarrjen e pavarur të këtyre grupeve, duke përfshirë mungesën e rampave të aksesit, ashensorëve të përshtatur, apo shenjave në gjuhë të shenjave për personat me dëmtime dëgjimore. Kjo mungesë e

¹ Fatura, deklarata, formular aplikimi, vërtetime, kërkesa etj.

aksesit fizik krijon barriera në përdorimin e drejtë dhe të barabartë të shërbimeve gjyqësore.

Në këtë kontekst, është e nevojshme që institucionet gjyqësore të ndërmarrin masa konkrete për përmirësimin e aksesit fizik dhe shërbimeve mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat, duke garantuar respektimin e parimeve të drejtësisë dhe barazisë për të gjithë qytetarët.

Në përfundim, standardi i qasjes në informacionin publik dhe transparencës nuk është i plotësisht i realizuar. Ndërsa ekzistojnë elemente bazë funksionale dhe procedura për qasje, ka mangësi të dukshme që lidhen me përditësimin dhe plotësinë e informacionit online, infrastrukturën fizike dhe shërbimet për qytetarët, qasjen për personat me aftësi të. Përmirësimi i këtyre faktorëve kërkon forcimin e transparencës përmes përditësimit të faqes online, standardizimin e sporteleve dhe dhomave të pritjes, rritjen e aksesit për personat me nevoja të veçanta.

KREU II-ROLI I GJYKATËS NË ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

II.1 PRAKTIKA E LËSHIMIT TË URDHRAVE TË MBROJTJES NGA GJYKATA

Gjyqtarët kanë një rol qendror në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen nga dhuna në familje. Përmes vendimmarrjes së tyre, ata përcaktojnë mënyrën konkrete se si ligji interpretohet dhe zbatohet në praktikë, duke garantuar që standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të zbatohen me ndjeshmëri gjinore dhe me kujdesin e duhur (*due diligence*).

Në këtë kontekst, gjyqtari është përgjegjës për të siguruar mbrojtje efektive për viktimat, për të parandaluar përsëritjen e dhunës dhe për të shmangur viktimizimin dytësor gjatë procesit gjyqësor. Vendimmarrja e kujdesshme, e bazuar në prova dhe në rrethanat individuale të secilit rast, është thelbësore për të garantuar qasje të drejtë në drejtësi dhe trajtim dinjitoz për viktimat.

Lëshimi i urdhërave të mbrojtjes përbën një nga mjetet kryesore në duart e gjykatës për të siguruar ndërhyrje të menjëhershme dhe mbrojtje reale ndaj viktimave të dhunës. Megjithatë, ky proces mbetet kompleks, pasi gjyqtarët përballen me një sërë sfidash që lidhen me mungesën e provave të drejtpërdrejta, hezitimin e viktimave për të dëshmuar, apo mungesën e bashkëpunimit ndërinstitutional.

Në këto kushte, gjyqtari duhet të demonstrojë profesionalizëm, ndjeshmëri dhe njohje të thellë të legjislacionit material dhe procedural, duke interpretuar ligjin në funksion të mbrojtjes së jetës dhe integritetit të viktimave.

Gjatë periudhës së monitorimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se 48% e çështjeve janë pranuar ose pranuar pjesërisht, ndërsa 52% e tyre janë rrëzuar/ refuzuar. Ky raport tregon që afërsisht gjysma e kërkesave për urdhër mbrojtjeje marrin mbështetje nga gjykata, ndërsa gjysma tjetër përballlet me refuzim.


Një përqindje e lartë e rrëzimeve/ refuzimeve mund të sinjalizojë që shumë kërkesa nuk plotësojnë kriteret ligjore ose nuk shoqërohen me prova të mjaftueshme. Një tjetër faktor që mund të ndikojë është mungesa e njohurive të viktimave mbi procedurat ligjore dhe të drejtën e tyre për mbrojtje, që shpesh sjell paraqitje jo të plotë ose jo të saktë të kërkesave.

Rrëzimi/ refuzimi i një numri të madh çështjesh mund të ketë edhe një efekt psikologjik negativ tek viktimat, duke zvogëluar besimin tek sistemi gjyqësor dhe duke i bërë ato të hezitojnë të kërkojnë mbrojtje në të ardhmen. Një raport pranimit-rrëzimi i tillë ka implikime të rëndësishme për të drejtën e viktimave për një proces të drejtë dhe efektiv, pasi rrëzimi i çështjeve mund të kufizojë mundësinë e tyre për të marrë mbrojtje dhe të cenojë ndjenjën e sigurisë.

Për të përmirësuar këtë situatë është e nevojshme të rritet asistenca juridike dhe sociale për viktimat, të përmirësohen procedurat e paraqitjes së kërkesave dhe të bëhet një monitorim më i detajuar i arsyetimit të vendimeve. Një qasje e tillë do

të ndihmonte në zvogëlimin e pengesave për viktimat dhe në forcimin e efektivitetit të masave mbrojtëse, duke siguruar që procesi gjyqësor të mos mbetet vetëm një formë procedurale, por një mekanizëm real mbrojtjeje.

Ndarja e çështjeve për Urdhër Mbrojtjeje në Gjykatën e Tiranës



II.2 GARANCIA E PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR PËR VIKTIMAT E DHUNËS

Dhuna ndaj grave shihet si një shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi gjinor, që përfshin çdo akt dhune që shkakton ose mund të shkaktojë dëmtim fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik për gratë. Në dhunë përfshihen edhe kërcënimet, shtrëngimet ose privimi arbitrar i lirisë, qoftë në jetën private apo publike. E drejta për një proces të rregullt ligjor është një garanci themelore për qytetarët kundër veprimeve të padrejta të autoriteteve dhe një detyrim për institucionet për të respektuar procedurat ligjore, në mënyrë që të mos çenojnë të drejtat dhe liritë e individëve. Ky parim përbën një element bazë të shtetit të së drejtës dhe nuk kufizohet vetëm në të drejtat kushtetuese, por shtrihet edhe në të drejtat e njohura nga ligjet në fuqi.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 42, parashikon që çdo ndërhyrje që prek lirinë, pronën ose të drejtat kushtetuese dhe ligjore duhet të ndodhë në përputhje me një proces të rregullt dhe të drejtë ligjor. Në këtë kuadër, dispozita 6 e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themeltore (KEDNJ) dhe neni 29 i Konventës së Stambollit vendosin standarde që përfshijnë një gjykim të drejtë dhe publik, zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm kohor, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj.

Shtetet që janë pjesë e KEDNJ-së kanë përgjegjësi aktive për të krijuar dhe mbajtur institucione që ofrojnë një administrim efikas të drejtësisë dhe për të siguruar që procedurat gjyqësore janë të drejta dhe të paanshme. Këto garanci zbatohen jo

vetëm gjatë procesit gjyqësor, por edhe në fazat paraprake dhe pasuese të tij (neni 6 i KEDNJ-së). Po ashtu, Konventa e Stambollit kërkon që shtetet të marrin masa legislative ose masa të tjera për t'u siguruar viktimave mjete ligjore adekuate civile kundër autorëve të veprave penale dhe ndaj autoriteteve që nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre për mbrojtjen e viktimave (neni 29 i Konventës së Stambollit).

Në këtë pjesë të studimit do të zhvillohet një analizë e thelluar e garancive që parashikon neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke shqyrtuar në veçanti të drejtën për një proces gjyqësor të rregullt dhe mënyrën se si respektohen këto garanci në praktikën gjyqësore lidhur me lëshimin e urdhërave të mbrojtjes.

II.3 GJYKIM I DREJTË DHE PUBLIK

Një nga garancitë kryesore që siguron legjislacioni është e drejta për një gjykim të drejtë, siç parashikohet në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ky parim përfshin një gamë të gjerë elementësh të procesit gjyqësor, përfshirë të drejtën për akses në gjykatë, barazinë në mjetet ligjore, mundësinë për të zhvilluar seanca me palë kundërshtare, si dhe sigurimin e një shqyrtimi të arsyeshëm të çështjes.

E drejta për akses në gjykatë nënkupton, në themel, mundësinë për të nisur procedura gjyqësore dhe për të kërkuar mbrojtje ligjore përmes institucioneve gjyqësore. Megjithatë, kjo e drejtë nuk mjafton të ekzistojë në mënyrë formale, ajo duhet të jetë funksionale dhe efektive në praktikë.

Për viktimat e dhunës në familje, kjo do të thotë që të kenë mundësinë e plotë për të ushtruar disa të drejta bazë, duke përfshirë të drejtën për t'u drejtuar gjykatës, të drejtën për të bërë ankim, të drejtën për ndihmë juridike falas, të drejtën për një shqyrtim në një afat të arsyeshëm kohor dhe të drejtën që çështja e tyre të shqyrtohet nga një gjykatë e ligjshme dhe e paanshme.

Këto elementë përbëjnë gurrthemelin e një procesi të drejtë dhe publik, dhe janë të domosdoshme për të garantuar që viktimat të kenë akses real dhe të barabartë në drejtësi.

A) E DREJTA PËR T'U DREJTUAR GJYKATËS

Sipas dispozitave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), çdo individ ka të drejtë të kërkojë mbrojtje ligjore në gjykatë kur pretendohet një shkelje e një të drejte civile, duke pasur në dispozicion mjete ligjore të mjaftueshme për këtë qëllim. Kjo e drejtë përbën një element kyç të procesit të

drejtë ligjor dhe është thelbësore për sigurimin e barazisë përpara ligjit dhe për mbrojtjen e të drejtave të individëve.

E drejta për akses në gjykatë nuk duhet të kuptohet në mënyrë të kufizuar si mundësia për të ndjekur vetëm procedura brenda gjykatave, por ajo shtrihet edhe në procedura pranë organeve të tjera shtetërore, përfshirë proceset e ankimit administrativ. Kjo qasje pasqyron një interpretim gjithëpërfshirës të aksesit në drejtësi, duke siguruar që individët, përfshirë viktimat e dhunës në familje, të mund të kërkojnë mbrojtje jo vetëm përmes rrugëve gjyqësore, por edhe përmes mekanizmave të tjera ligjore që kanë për qëllim të korrigjojnë padrejtësi.

Mohimi i kësaj të drejte, apo pamundësia për të marrë një përgjigje përfundimtare nga gjykata për pretendimet e ngritura, përbën një shkelje të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor. Një kufizim i tillë jo vetëm cenon parimin kushtetues të barazisë para ligjit, por gjithashtu dëmton besimin e publikut tek sistemi gjyqësor. Në praktikë, kjo mund të rezultojë në pamundësi për viktimat të kërkojnë mbrojtje adekuate dhe të shfaqë një ndjenjë të mungesës së sigurisë dhe mbështetjes institucionale.

Në kontekstin e dhunës në familje, garantimi i kësaj të drejte është veçanërisht i rëndësishëm. Viktimat shpesh përballen me sfida të mëdha për të kërkuar ndihmë, për shkak të frikës, presionit apo mungesës së njohurive mbi procedurat ligjore. Prandaj, shtetet kanë përgjegjësi jo vetëm për të siguruar ekzistencën formale të kësaj të drejte, por edhe për ta bërë atë efektive në praktikë. Kjo kërkon sigurimin e mekanizmave mbështetës, si shërbime për informacion dhe ndihmë juridike falas, që lehtësojnë aksesin e viktimave në gjykata dhe garantojnë që kërkesat e tyre të shqyrtohen në mënyrë të plotë dhe të drejtë.

Ky parim është i përcaktuar qartë edhe në Konventën e Stambollit, e cila thekson rëndësinë e krijimit të një sistemi që i mundëson çdo individ të ushtrojë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të arsyeshëm, duke u siguruar që mekanizmat ligjorë dhe institucionet të jenë të disponueshme dhe të qasshme për të gjithë.

B) E DREJTA E ANKIMIT

Sipas jurisprudencës kushtetuese, ushtrimi efektiv i së drejtës për ankim kërkon realizimin e dy aspekteve themelore: aspektit formal-procedural dhe aspektit substancial. Kërkesat procedurale të ankimit kanë si qëllim kryesor sigurimin e aksesit të individëve për të ushtruar këtë të drejtë ndaj vendimeve gjyqësore. Çdo shkallë ankimi që njohin normat procedurale civile ose penale është pjesë përbërëse e së drejtës së individit për akses në drejtësi. Gjykata ka theksuar se administrimi i drejtësisë fillon me garancinë që çdo individ të ketë mundësinë për të ushtruar një shqyrtim të plotë të çështjes së tij përpara një gjykate kompetente.

Në kuadër të ligjit “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, i ndryshuar, vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes është titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet. Megjithatë, kundër vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose moslëshimin e tij, është e mundur të bëhet ankim brenda pesë ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ndërkaq, viktimat nuk ka të drejtë të ankimojë vendimin e gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, përveç në rastin kur pretendon se masat e vendosura nuk sigurojnë mbrojtje adekuate. Rezerva ligjore që lejon ankimin vetëm kur viktimat pretendon se masat e vendosura nuk garantojnë mbrojtje, në praktikë nuk është e mjaftueshme për të garantuar një të drejtë reale ankimi. Interpretimi i ngushtë nga ana e gjykatave mbi këtë formulim ka krijuar situata ku viktimat janë përjashtuar nga kjo e drejtë në shumë raste, duke minuar parimin e aksesit në drejtësi dhe efikasitetin e masave mbrojtëse. Ky kufizim procedural synon të shmangë zvarritjen e proceseve dhe të garantojë që urdhri i mbrojtjes të hyjë në fuqi sa më shpejt, duke mbrojtur menjëherë jetën dhe sigurinë e viktimës. Megjithatë, në praktikë, ky rregull shpesh krijon situata ku viktimat mbetet pa mundësi reale për të kërkuar rishikimin e vendimit, edhe kur ndien se masat e caktuara janë të pamjaftueshme për garantimin e sigurisë së saj.

Në disa raste, gjykata mund të vendosë masa standarde pa marrë parasysh rrethanat specifike të rastit, si rrezikshmëria e dhunës, historiku i dhunës apo nevoja për masa shtesë mbrojtjeje. Në mungesë të së drejtës për ankim të plotë, viktimat mbetet e varur nga vlerësimi fillestar i gjykatës së shkallës së parë. Kjo situatë mund të cenojë parimin e mbrojtjes efektive të të drejtave dhe aksesin e plotë në drejtësi, veçanërisht nëse vendimi fillestar nuk reflekton nevojat reale të viktimës.

Për këtë arsye, ekspertët dhe organizatat që merren me mbrojtjen e të drejtave të grave kanë rekomanduar rishikimin e kuadrit ligjor në mënyrë që t’i jepet viktimës një e drejtë më e gjerë ankimi, të paktën për aspektet që lidhen me masën, kohëzgjatjen ose zbatimin e urdhrit të mbrojtjes. Një qasje e tillë do të siguronte më shumë balancë midis nevojës për mbrojtje të menjëhershme dhe të drejtës për një mjet efektiv juridik, duke e afruar praktikën shqiptare me standardet e Konventës së Stambollit dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është se paraqitja e ankimit nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose të urdhrit të mbrojtjes. Ky parim është thelbësor për të garantuar mbrojtje të menjëhershme dhe efektive për viktimën, duke siguruar që masat e vendosura nga gjykata të zbatohen pa vonesë, pavarësisht se pala e paditur mund të ketë ushtruar të drejtën e ankimit. Qëllimi kryesor është parandalimi i çdo rreziku të mundshëm ndaj viktimës në periudhën ndërmjet dhënies së vendimit dhe shqyrtimit të ankimit nga shkalla më e lartë, pasi çdo vonesë në ekzekutim mund të ketë pasoja të rënda për sigurinë fizike dhe psikologjike të saj.

Në këtë mënyrë, sistemi gjyqësor synon të ruajë ekuilibrin ndërmjet të drejtës së palës së paditur për të apeluar dhe nevojës emergjente për mbrojtjen e viktimës. Megjithatë, në praktikë, zbatimi i menjëhershëm i vendimit kërkon koordinim të ngushtë ndërmjet gjykatës, policisë dhe shërbimeve të tjera mbështetëse, për të

siguruar që masat e urdhrit të mbrojtjes të jenë të efektshme dhe të monitoruara në mënyrë të vazhdueshme. Në disa raste, mungesa e burimeve apo vonesat në komunikimin ndërinstytucional mund të ndikojnë në kohën e ekzekutimit, duke dobësuar mbrojtjen që ligji synon të garantojë.

Megjithatë, ruajtja e parimit që ankimi nuk pezullon ekzekutimin e urdhrit të mbrojtjes përbën një mekanizëm të domosdoshëm për mbrojtjen e menjëhershme të viktimave të dhunës në familje dhe përmbush një nga standardet kryesore të Konventës së Stambollit, e cila kërkon që shtetet të sigurojnë mbrojtje efektive, të shpejtë dhe pa pengesa procedurale ndaj çdo forme dhune.

Monitorimi tregon një përqindje të ulët të ankimeve në çështjet me objekt lëshimin e urdhërave të mbrojtjes. duke reflektuar një dinamikë të veçantë në trajtimin gjyqësor të rasteve të dhunës në familje. Kjo tendencë mund të interpretohet si pasojë e disa faktorëve të ndërlidhur. Nga njëra anë, përqindja e ulët e ankimeve mund të sinjalizojë pranimin e vendimeve të gjykatës nga palët, duke sugjeruar se masat e vendosura janë perceptuar si të drejta dhe të përshtatshme për situatën konkrete. Nga ana tjetër, ajo mund të pasqyrojë edhe vështirësitë praktike dhe psikologjike me të cilat përballen viktimat në procesin e ndjekjes së ankimit, përfshirë mungesën e ndihmës juridike, kostot ekonomike, frikën nga përballja me dhunuesin apo mungesën e besimit tek efektiviteti i instancës së apelimit.

Në shumë raste, viktimat e dhunës në familje e shohin vendimin e shkallës së parë si mjetin e vetëm për të siguruar mbrojtje të menjëhershme, pa e konsideruar ankimin si një hap praktikisht të realizueshëm. Për më tepër, kufizimet ligjore që parashikojnë të drejtën e ankimit vetëm në rastet kur viktimat pretendon se masat e vendosura nuk janë të mjaftueshme, e reduktojnë edhe më shumë numrin e rasteve të apelimit. Kjo tregon se, ndonëse ligji synon të garantojë mbrojtje të menjëhershme dhe efikase, në praktikë, ai mund të kufizojë mundësinë e rishikimit të vendimeve, duke ndikuar në balancën midis mbrojtjes së viktimës dhe të drejtës për një proces të plotë gjyqësor.

Për këtë arsye, përqindja e ulët e ankimeve duhet të analizohet jo thjesht si tregues i stabilitetit të vendimeve gjyqësore, por si shenjë e nevojës për forcimin e mekanizmave mbështetës dhe rritjen e ndërgjegjësisë juridik të viktimave. Vetëm nëpërmjet ndihmës efektive ligjore, aksesit të lehtësuar në apel dhe garancive për sigurinë e tyre gjatë procedurave gjyqësore, mund të sigurohet një mbrojtje reale dhe e plotë, në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit dhe të drejtën për një proces të drejtë të sanksionuar nga KEDNJ.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, *“Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, i ndryshuar, ka synuar garantimin e një procedure të përsheptuar gjyqësore për trajtimin e kërkesave për urdhra mbrojtjeje, duke parashikuar afate të shkurtuara si në shkallën e parë, ashtu edhe në Gjykatën e Apelit. Në bazë të këtij ligji, Gjykata e Apelit është e detyruar të marrë vendim brenda 15 ditëve nga regjistrimi i ankimit, ndërsa afati për paraqitjen e tij është reduktuar nga 15 në 5

ditë, me qëllim sigurimin e një reagimi të menjëhershëm në rastet e dhunës në familje.

Megjithatë, zbatimi praktik i këtyre dispozitave tregon një mospërputhje të dukshme midis qëllimit ligjor dhe realitetit gjyqësor. Në shumicën e rasteve, afatet e gjykimit në apel nuk respektohen, duke shkaktuar vonesa që minojnë funksionimin efektiv të së drejtës për ankim dhe, rrjedhimisht, mbrojtjen që ligji synon t'i sigurojë viktimave. Këto vonesa krijojnë një periudhë pasigurie juridike dhe rreziku për viktimat, të cilat mund të mbeten pa mbrojtje të plotë gjatë kohës që çështja pret shqyrtimin.

Kështu, ndonëse legjislacioni shqiptar parashikon mekanizma formalë për mbrojtje të menjëhershme dhe për një proces të shpejtë gjyqësor, zbatimi i pamjaftueshëm i afateve ligjore në praktikë e dobëson ndjeshëm efektivitetin e sistemit dhe e bën më të vështirë sigurimin e një mbrojtjeje reale dhe të qëndrueshme për viktimat e dhunës në familje.

Ndryshimet ligjore të miratuara në vitin 2018, të cilat hoqën të drejtën për paraqitjen e rekursit në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të dhëna nga gjykata e apelit në çështjet me objekt lëshimin e urdhërave të mbrojtjes, kanë reduktuar ndjeshëm mundësinë e kontrollit juridik mbi këto vendime. Ky ndryshim ka sjellë pasoja të rëndësishme në garantimin e të drejtës për një proces të plotë dhe efektiv ligjor, pasi kufizon rrethin e mjeteve që viktimat mund të përdorë për të kërkuar rishqyrtimin e një vendimi që mund të mos i ofrojë mbrojtje të mjaftueshme ose që nuk pasqyron rrezikshmërinë reale të situatës.

Në praktikë, kjo nënkupton se pas shqyrtimit në apel, viktimat nuk ka më asnjë mjet të brendshëm ligjor për të kërkuar korrigjimin e mundshëm të një vendimi të padrejtë apo të pamjaftueshëm. Kështu, garancia për kontroll të shumëfishtë gjyqësor, një element i rëndësishëm i së drejtës për proces të drejtë është dobësuar ndjeshëm. Kjo situatë është veçanërisht problematike në rastet e dhunës në familje, ku pasojat e një vendimi të pamjaftueshëm mund të jenë të rënda dhe të pariparueshme për sigurinë e viktimës.

Në këtë kontekst, reduktimi i shkallëve të ankimit bie ndesh me frymën e Konventës së Stambollit dhe me standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat kërkojnë që shtetet të garantojnë mekanizma efektivë për mbrojtjen dhe rishikimin e vendimeve që prekin sigurinë dhe të drejtat themelore të individit. Prandaj, pavarësisht se ndryshimet e vitit 2018 synonin përsheptimin e procedurave dhe uljen e ngarkesës në Gjykatën e Lartë, në praktikë ato kanë kufizuar ndjeshëm të drejtën e viktimave për një kontroll të plotë juridik dhe për mbrojtje efektive ndaj dhunës.

Ky realitet kërkon rishqyrtim të procedurave dhe përmirësim të mekanizmave ligjorë për të siguruar që e drejta për ankim të jetë një instrument real dhe efektiv për viktimat e dhunës në familje.

C) E DREJTA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Ndihma juridike falas përfaqëson një mekanizëm thelbësor në garantimin e barazisë së qytetarëve përpara ligjit, duke siguruar qasje efektive në drejtësi për individët që ndodhen në kushte të pafavorizuara. Ajo garanton që çdo person, pavarësisht nga statusi ekonomik apo social, të ketë mundësinë të drejtohet në gjykatë për të kërkuar shqyrtimin e pretendimeve të tij. Ky instrument ligjor nuk ka për qëllim vetëm garantimin e barazisë formale përpara ligjit, por synon të sigurojë edhe barazi reale në praktikë. Në rastet kur individët përballen me pamundësi ekonomike apo i përkasin grupeve sociale të marginalizuara, ekziston rreziku që e drejta për mbrojtje ligjore të mbetet thjesht një nocion teorik, pa ndikim të prekshëm në jetën e tyre. Ndihma juridike falas është një mjet thelbësor për të kapërcyer jo vetëm pengesat financiare, por edhe barrierat sociale që kufizojnë qasjen efektive në drejtësi.

Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) garanton të drejtën për mbrojtje, duke parashikuar se çdo i akuzuar ka të drejtë të mbrohet personalisht ose nëpërmjet asistencës ligjore sipas zgjedhjes. Nëse ky individ nuk disponon mjetet e nevojshme për të paguar përfaqësimin ligjor, shteti është i detyruar t'i sigurojë atë pa pagesë, kur kjo kërkohet dhe kur interesat e drejtësisë e kërkojnë.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 *“Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, i ndryshuar, parashikon qartë detyrimin e shtetit për të garantuar përfaqësimin ligjor falas për viktimat e dhunës në familje. Ky parim përforcohet edhe nga Ligji nr. 111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*, i cili rregullon organizimin dhe mënyrën e ofrimit të kësaj shërbimi.

Sigurimi i ndihmës juridike falas ka një rëndësi të veçantë për viktimat e dhunës në familje, të cilat shpesh ndodhen në një pozitë të dobët ekonomike dhe sociale dhe përballen me vështirësi të mëdha për të ushtruar të drejtat e tyre. Kjo ndihmë nuk është vetëm një mbështetje ligjore, por edhe një mjet esencial për garantimin e aksesit të tyre në drejtësi, duke lehtësuar procesin dhe duke fuqizuar pozitën juridike të viktimave.

Mosofrimi i ndihmës juridike falas në situatat kur ajo është e nevojshme mund të përbëjë një shkelje të të drejtës për një proces të drejtë dhe të barabartë, siç parashikohet në nenin 6 të KEDNJ-së dhe në dispozitat kushtetuese. Për këtë arsye, funksionimi efektiv i këtij instituti është një komponent kyç i mbrojtjes ligjore për viktimat e dhunës në familje dhe një element i domosdoshëm për realizimin e drejtësisë në praktikë.

Në kuadër të garantimit të drejtësisë dhe mbrojtjes së të drejtave të viktimave, përfaqësimi ligjor është një element thelbësor. Nga monitorimi i vendimeve rezulton se vetëm 39 nga 176 viktima të dhunës në familje janë mbrojtur me avokat. Pra

vetëm rreth 22% e viktimave kanë përfituar nga kjo mbështetje ligjore profesionale. Kjo shifër është shqetësuese dhe reflekton një mungesë të theksuar në aksesin e viktimave ndaj mbrojtjes ligjore, duke vënë në rrezik realizimin e plotë të të drejtave të tyre në procesin ligjor. Parimet themelore të sistemit tonë juridik dhe normat ndërkombëtare, përfshirë Kushtetutën e Republikës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sigurojnë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe për përfaqësim ligjor, çka e bën mbrojtjen me avokat të domosdoshme për të garantuar barazinë para ligjit. Mungesa e përfaqësimit profesional për shumicën e viktimave krijon një hendek të qartë mes tyre dhe palës tjetër në procedurë, e cila shpesh ka akses më të mirë në ndihmë juridike. Kjo mungesë mund të çojë në humbje të të drejtave, mosrealizim të kërkesave për dëmshpërblim dhe përkeqësim të pozicionit juridik të viktimave në përgjithësi. Një proces ligjor që nuk siguron mbrojtje të barabartë për të gjitha palët çënon jo vetëm besimin në sistemin e drejtësisë, por edhe vetë parimet themelore të drejtësisë dhe të barazisë para ligjit.

Nga ana e institucioneve shtetërore dhe atyre ligjore, ekziston një detyrim i qartë për të siguruar shërbime të ndihmës juridike falas dhe të aksesueshme, si dhe për të promovuar ofrimin e përfaqësimit ligjor për viktimat që nuk kanë mundësi të paguajnë për avokat.

Sipas ligjit nr.111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”* viktimat e dhunës në familje janë kategori e vecantë përfituese e ndihmës juridike falas ², pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre.

Neni 22 i ligjit përcakton se “Vendimi në lidhje me kërkesën për ndihmë juridike dytësore merret nga gjykata kompetente: a) brenda 5 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës, kur kërkesa paraqitet përpara fillimit të procesit gjyqësor; b) gjatë veprimeve paraprake ose në seancën përgatitore përpara se të caktohet seanca gjyqësore, kur kërkesa për ndihmë juridike është paraqitur bashkë me kërkesë-padinë”.

Referuar ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, i ndryshuar, gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme:

- I. të një të mituri, brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës;
- II. të subjekteve të tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare, brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës.

Këto dy nene krijojnë një kolizion në praktik. Neni 22 i ligjit për ndihmën juridike falas i jep gjykatës deri në pesë ditë për të vendosur mbi kërkesën për ndihmë juridike dytësore, ndërkohë që ligji për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare kërkon që gjykata të vendosë brenda 24 orëve për të miturit dhe 48 orëve

² Neni 11 gërma a)

për subjektet e tjera mbi kërkesat për mbrojtje të menjëhershme. Ky moskoordinim bën që viktimat shpesh të përballet me seancën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje pa përfaqësim ligjor, pasi gjykata nuk ka vendosur ende mbi ndihmën juridike. Në këtë mënyrë, e drejta për mbrojtje procedurale dhe për një proces të drejtë mbetet formale, pasi viktimat nuk ka mundësi reale të paraqesë prova, të argumentojë kërkesën e saj apo të kundërshtojë pretendimet e palës tjetër.

Si pasojë, efektiviteti i urdhrave të mbrojtjes rrezikon të cenohet, duke dobësuar qëllimin e ligjit për dhunën në familje që synon mbrojtje të menjëhershme dhe të plotë të viktimave.

Përveç kolizionit të parashtruar në ligj, në praktikë konstatohet se vonesat në vendimmarrjen e gjykatës mbi kërkesat për ndihmë juridike dytësore tejkalojnë shpesh afatin ligjor prej 5 ditësh. Kjo përbën një problem të rëndësishëm, pasi zvarritja e vendimeve e lë viktimën në një gjendje pasigurie ligjore dhe pa mbrojtje efektive gjatë periudhës më kritike të procesit.

Një problem tjetër thelbësor është mungesa e informimit të duhur dhe njohjes së të drejtave nga ana e viktimave. Shumë prej tyre nuk janë të vetëdijshëm se kanë të drejtë të përfaqësohen nga avokat në seancat gjyqësore, ose nuk dinë si dhe kur të kërkojnë ndihmë juridike falas. Si rezultat, ato nuk kërkojnë mbrojtje ligjore në kohën e duhur (gjatë veprimeve paraprake ose në seancën përgatitore përpara se të caktohet seanca gjyqësore), duke u ekspozuar ndaj rrezikut të marrjes së vendimeve pa përfaqësim adekuat, gjë që dëmton mundësinë për një proces të drejtë dhe mbrojtjen e plotë të interesave të tyre.

Kombinimi i vonesave në sistemin gjyqësor dhe mungesës së informacionit për të drejtat ligjore të viktimave krijon një hendek të madh midis parimit formal të drejtësisë dhe realizimit praktik të saj, duke cenuar rëndë efektivitetin e masave për mbrojtje të menjëhershme ndaj dhunës në familje.

Nëse nuk gjykohen në një kohë shumë të shkurtër këto kërkesa e humbin qëllimin e tyre pasi një kërkesë e tillë praktikisht pranohet nga gjykata pas përfundimit të procesit gjyqësor për lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes, i cili ka afate të shkurtra kohore gjykimi.

Në këtë kuptim, harmonizimi i afateve ose vendosja e një mekanizmi që garanton përfaqësim ligjor automatik (një listë me avokat të specializuar për çështjet e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje), për viktimat e dhunës në familje është një domosdoshmëri për të siguruar mbrojtje reale dhe jo vetëm formale të të drejtave të tyre.

Aktualisht, viktimat e dhunës në familje përfitojnë ndihmë juridike falas vetëm për çështjet civile. Ky kufizim lë jashtë një pjesë të rëndësishme të nevojave të

viktimave, pasi shpesh ato përballen edhe me procese penale kundër dhunuesit në cilësinë e viktimës së krimit, ku përfaqësimi ligjor është thelbësor për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e tyre.

Prandaj, është e nevojshme që ligji për ndihmën juridike falas të zgjerohet dhe të përfshijë edhe çështjet penale që lidhen me dhunën në familje, për të siguruar që viktimat të kenë mbështetje të plotë ligjore gjatë gjithë procesit gjyqësor. Kjo jo vetëm do të forconte mbrojtjen e të drejtave të tyre, por edhe do të rriste efektivitetin e luftës kundër dhunës në familje.

Në ndryshim nga pozita e mëparshme, që nga viti 2017 viktimat e veprës penale është palë në procesin penal dhe ka të drejta procedurale që i japin një rol aktiv në këtë proces. Ky është një ndryshim thelbësor që e dallon pozitën e saj, nga pozita pasive e mëparshme. Kreu VI i Kodit të Procedurës Penale “Viktima, Viktima Akuzuese, Paditësi dhe i padituri civil” rregullon të drejtat e viktimës së veprës penale.

Ligjërisht viktimat e krimit kanë një sërë të drejtash procedurale, si e drejta për t’u informuar për ecurinë e çështjes, për të marrë pjesë në seanca gjyqësore, për të paraqitur prova, për të kërkuar masa mbrojtëse apo për të apeluar vendimet gjyqësore. Megjithatë, nëse viktimat nuk përfaqësohen nga një avokat, këto të drejta shpesh mbeten vetëm formale dhe nuk realizohen në praktikë. Kjo ndodh sepse viktimat nuk kanë njohuri të mjaftueshme juridike për të kuptuar procedurat gjyqësore, afatet ligjore apo mënyrat e ushtrimit të të drejtave të tyre. Për më tepër, shumë viktimat ndodhen në gjendje psikologjike dhe sociale të vështirë, që i pengon të përballen vetëm me sistemin e drejtësisë. Si rrjedhojë, mungesa e përfaqësimit ligjor i ekspozon ato ndaj rrezikut të humbjes së të drejtave thelbësore dhe zvogëlon ndjeshëm aksesin e tyre real në drejtësi.

Si konkluzion mund të themi se pjesëmarrja në gjykim, ushtrimi i së drejtës së mbrojtjes, si dhe efektiviteti i mbrojtjes, janë aspekte të procesit të rregullt ligjor, të lidhura mes tyre dhe që plotësojnë njëra-tjetrën për garantimin e së drejtës së mbrojtjes çënohet në shumë rast. Ushtrimi i të drejtës së mbrojtjes, jo vetëm do t’i siguronte kërkuar një mbrojtje efektive, por do t’i jepte mundësinë të gëzonte të gjithë garancitë e gjyqësorit të rregullt ligjor. Maksimizimi i pjesëmarrjes aktive dhe të sigurt të viktimës në procedimet penale duke minimizuar rreziqet e viktimizimit dytësor dhe rritjen e aftësisë për të gëzuar të drejtat e tyre realizohet vetëm nëpërmjet ndihmës juridike dytësore falas.

Në tërësi, situata aktuale është një tregues i qartë i nevojës për reforma dhe masa konkrete që të sigurojnë mbrojtje ligjore efektive për të gjitha viktimat dhe të garantojnë respektimin e parimeve themelore të drejtësisë dhe të të drejtave të njeriut.

D) E DREJTA PËR NJË GJYKIM TË ARSYESHËM

Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) kërkon që gjykatat vendase të japin arsyetim për vendimet e tyre, qoftë në çështje civile, qoftë në çështje penale. Kjo garanci është themelore për transparencën e procesit gjyqësor dhe për sigurimin e mundësisë që palët të kuptojnë bazën ligjore dhe faktike të vendimeve. Arsyetimi i vendimeve është gjithashtu një instrument kontrolli mbi veprimet gjyqësore, duke siguruar që vendimet të jenë të drejta, të arsyetuara dhe në përputhje me ligjin.

Gjykatat nuk kanë detyrimin për t'u përgjigjur në mënyrë të detajuar për çdo pikë të diskutuar, por kur një kërkesë ose një çështje ka rëndësi vendimtare për rezultatin e çështjes, ajo duhet të trajtohet në mënyrë specifike në vendim. Mungesa e arsyetimit të detajuar ose i bindshëm konsiderohet një shkelje e të drejtës për një gjykim të arsyeshëm, dhe në këtë mënyrë cenon parimin e drejtësisë dhe transparencës.

Realizimi efektiv i të drejtës për një gjykim të arsyeshëm kërkon jo vetëm respektimin formal të afateve dhe procedurave, por edhe sigurimin e një arsyetimi të qartë dhe të plotë të vendimeve gjyqësore. Ky parim është thelbësor për të garantuar që procesi gjyqësor të mos jetë vetëm një procedurë formale, por një proces ku drejtësia zbatohet në mënyrë transparente dhe të kuptueshme për të gjitha palët.

Arsyetimi i vendimit gjyqësor për lëshimin ose moslëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes është një element thelbësor për garantimin e drejtësisë, transparencës dhe legjitimitetit të procesit gjyqësor. Një vendim i mirëarsyetuar duhet të përmbajë një analizë të plotë dhe të detajuar të rrethanave konkrete të rastit, të provave të paraqitura, si dhe të bazës ligjore që justifikon masën e marrë.

Shpesh në vendime përdoren formulime të përgjithshme, që nuk lidhen në mënyrë specifike me faktet dhe provat e rastit konkret. Në disa raste, përgatitja e arsyetimit bazohet në kopjimin e pjesëve nga vendime të tjera, veçanërisht nga dëshmitë e të paditurit në raste të ndryshme. Kjo metodë jo vetëm që tregon mungesë përkushtimi dhe profesionalizmi, por çënon edhe besueshmërinë e vendimit dhe mund të sjellë gabime substantiale në vlerësimin e situatës. Çdo rast ka veçantitë e veta që duhet të analizohen individualisht dhe me kujdes.

Gabimet në arsyetimin e urdhrave të mbrojtjes, veçanërisht rastet kur vërehet përsëritje apo përdorim i modeleve të njëjta nga vendime të mëparshme, tregojnë mungesë personalizimi dhe kujdesi të mjaftueshëm në analizën e çështjeve konkrete. Një qasje e tillë ndikon në cilësinë dhe qartësinë e arsyetimit gjyqësor, duke krijuar përshtypjen se vendimi nuk pasqyron në mënyrë të plotë specifikat dhe rrethanat individuale të rastit.

Kjo praktikë, edhe pse mund të jetë rezultat i ngarkesës së lartë të punës ose mungesës së standardeve të unifikuara të arsyetimit, rrezikon të dobësojë besueshmërinë dhe transparencën e procesit gjyqësor, si dhe të ndikojë në perceptimin e drejtësisë nga palët e përfshira. Një arsyetim i kujdesshëm, i individualizuar dhe i mbështetur në fakte konkrete është thelbësor për garantimin e një vendimmarrjeje të drejtë, të argumentuar dhe të besueshme.

Prandaj, rekomandohet që gjykatat të tregojnë kujdes të shtuar në përdorimin e gjuhës dhe strukturës së arsyetimit, duke siguruar që çdo vendim të reflektojë analizën specifike të provave dhe rrethanave të rastit, në përputhje me parimet e drejtësisë materiale dhe standardet ndërkombëtare për gjykim të paanshëm.

Gjithashtu në monitorim janë vënë re vendime të shkurtra dhe pa arsyetim të detajuar, fakt ky që është në kundërshtim me parimet themelore të drejtësisë, përfshirë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe transparent. Arsyetimi i mirë është thelbësor për të garantuar kontrollin e jashtëm të vendimit, si nga palët, ashtu edhe nga instancat e ankimit, dhe për të siguruar që masa është marrë në përputhje me ligjin dhe faktet konkrete të rastit.

Një problem i hasur në praktikë është dhënia e një vendimi që kufizohet në një përmbledhje formale të kërkesës, pa shpjeguar qartë pse dhe në çfarë mënyre plotësohen kriteret ligjore për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes. Vendime të tilla krijojnë një mungesë transparence dhe nuk mundësojnë kuptimin e plotë të arsyes së vendimit, as nga palët dhe as nga organet e kontrollit. Kjo situatë çon në pamundësi të ushtrimit efektiv të të drejtave të palëve, përfshirë edhe të drejtën për ankim ose rishqyrtim të vendimit.

Një vendim i mirëarsyetuar duhet të përmbajë referenca të qarta në dispozitat ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare në bazë të të cilave është marrë masa e urdhrit të mbrojtjes.

Mungesa e standardeve ndërkombëtare në arsyetimet gjyqësore përbën një mangësi të rëndësishme në respektimin e detyrimeve të Shqipërisë.

Monitorimi tregon se në 68 % të vendimeve (117 vendime nga 173 të monitoruara) nuk ka asnjë referencë ndaj akteve ndërkombëtare, ndërsa vetëm në 32 % (56 vendime) përmendet Konventa e Stambollit ose Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Kjo mungesë e përmendjes së standardeve ndërkombëtare në arsyetimet gjyqësore tregon një hendek të rëndësishëm në respektimin dhe zbatimin e detyrimeve ligjore ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e mbrojtjes nga dhuna në familje.

Ky fakt nënvizon nevojën për përf forcim të kapaciteteve të gjyqtarëve dhe aktorëve të tjerë në sistemin e drejtësisë për njohjen, interpretimin dhe përdorimin e akteve ndërkombëtare si instrumente kyçe në procesin e vendimmarrjes, duke garantuar

kështu një mbrojtje më efektive dhe të harmonizuar me standardet europiane dhe globale.

Mungesa e përdorimit të Konventës së Stambollit dhe të KEDNJ-së në arsyetimet gjyqësore mund të ndikojë negativisht në cilësinë e vendimeve dhe në besimin e publikut ndaj sistemit gjyqësor, duke sjellë mungesë të një qasjeje të unifikuar dhe gjithëpërfshirëse ndaj çështjeve të dhunës në familje.

Rekomandohet zhvillimi i trajnimeve të specializuara për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët, për të përmirësuar përdorimin e këtyre instrumenteve ndërkombëtare në praktikën gjyqësore, duke ndikuar pozitivisht në mbrojtjen e të drejtave të viktimave dhe forcimin e zbatimit të ligjit në këtë fushë.

Sipas nenit 15 paragrafi 3 i ligjit “Kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.”

Në 157 vendime nga 167, gjykata ka bazuar vendimet në “bindje të brendshme,” që përbën rreth 94 % të totalit. Vetëm në 11 raste janë administruar prova konkrete, që është rreth 6 % e vendimeve.

Bindja e brendshme në proceset për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes përbën një element kyç dhe thelbësor në praktikën gjyqësore, veçanërisht në çështjet e dhunës në familje ku procedurat duhet të jenë efikase dhe të shpejta për të garantuar mbrojtjen e viktimave. Në mungesë të provave materiale apo dëshmive konkrete, si një realitet praktik dhe ligjor në rastet e dhunës në familje, bindja e brendshme e gjykatësit bëhet mjeti bazë për marrjen e vendimeve të menjëhershme mbrojtëse.

Nga pikëpamja procedurale, kodi i procedurës civile, ligji material dhe praktika gjyqësore lejojnë që gjykata të bazojë vendimet në bindjen e brendshme të gjyqtarit, në përputhje me parimin e arsyetimit gjyqësor dhe parimin e përshpejtimit të procedurës, duke synuar parandalimin e dëmimit të mëtejshëm të viktimave. Ky instrument ligjor është i përputhshëm edhe me parimet themelore të të drejtave të njeriut, duke u fokusuar në të drejtën për jetë dhe siguri personale, si dhe në parimin e parandalimit dhe mbrojtjes ndaj dhunës.

Në aspektin material, përdorimi i bindjes së brendshme është gjithashtu i mbështetur në praktikën ndërkombëtare dhe instrumentet ligjore, siç janë Konventa e Stambollit dhe Dokumentet e Kombeve të Bashkuara, të cilat nxisin reagimin të menjëhershëm dhe efektiv të autoriteteve ndaj rasteve të dhunës në familje, pa u mbështetur gjithnjë në prova të gjera paraprake, të cilat në shumicën e rasteve janë të vështira për t'u siguruar.

Megjithatë, për të shmangur arbitraritetin dhe për të garantuar sigurinë juridike, është e domosdoshme që bindja e brendshme të jetë e arsyetuar në mënyrë të plotë, transparente dhe në përputhje me standardet ligjore dhe të drejtat themelore të palëve të përfshira. Kjo kërkon trajnim profesional të gjyqtarëve në interpretimin e provave indirekte, përdorimin e indicieve dhe vlerësimin kritik të situatës faktike dhe ligjore.

Në shumë raste vendimet nuk shpjegojnë në detaje se si janë marrë parasysh provat e paraqitura nga pala kërkuese, si dhe arsyet për refuzimin apo vlerësimin e kundërt të provave të palës tjetër. Pa këtë pjesë të arsyetimit, nuk mund të konstatohet nëse vendimi është marrë në mënyrë të drejtë dhe të ekuilibruar. Kjo cenon të drejtën e mbrojtjes dhe mund të çojë në vendime të padrejta.

Një element tjetër kritik është mosadresimi i kundërshtimeve apo pretendimeve të palës së paditur në arsyetimin e vendimit. Nëse ato nuk trajtohen qartësisht, përbën një shkelje të parimit të paanshmërisë dhe drejtësisë materiale, pasi vendimi mund të duket si i njëanshëm dhe jo i bazuar në shqyrtim të plotë të të gjitha rrethanave.

Në përfundim, bindja e brendshme në çështjet e urdhrave të mbrojtjes është një mjet juridik i domosdoshëm dhe efektiv për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, duke garantuar një reagim të shpejtë dhe parandalues ndaj rrezikut, ndërsa përdorimi i saj i kujdesshëm dhe i arsyetuar forcon besueshmërinë dhe drejtësinë e vendimeve gjyqësore.

Sipas nenit 14 paragrafi 5 i ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar “...Për nevoja të zhvillimit të gjykimit, kur rrethanat e çështjes e diktojnë, gjykata, sipas nevojës, mund të zhvillojë seancën gjyqësore në mungesë të palëve, pavarësisht nga konfirmimi i marrjes dijeni.”

Ky parashikim ligjor është një instrument procedural që synon të garantojë efikasitetin e procesit gjyqësor dhe shmangien e vonesave të pajustificuara në rastet e dhunës në familje. Dispozita që i jep gjykatës të drejtën të zhvillojë seancën gjyqësore në mungesë të palëve, kur rrethanat e çështjes e diktojnë, është në përputhje me parimin e mbrojtjes së interesit publik dhe të sigurisë së viktimës, si dhe me nevojën për të parandaluar zvarritjen e procedurave për shkak të mungesës së palëve apo refuzimit të qëllimshëm për të marrë pjesë në proces. Lëshimi i Urdhrit të Mbrojtjes në mungesë është një mekanizëm juridik që e mundëson gjykatës të veprojë shpejt dhe efektivisht në mbrojtje të viktimës, duke mos e bllokuar procesin për shkak të mungesës së palës së paditur. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet e dhunës ku çdo vonesë mund të sjellë pasoja serioze për sigurinë dhe shëndetin e viktimës.

Nga analiza e praktikës gjyqësore gjatë monitorimit rezulton se kjo dispozitë zbatohet në mënyrë të kufizuar, shpesh vetëm në raste ku viktimat nuk është e pranishme për arsye objektive. Në shumë raste, gjykatat tregojnë hezitim në zhvillimin e seancës në mungesë të palëve e sidomos të pales paditëse, edhe kur

ligji e lejon këtë, duke rezultuar në vonesa të panevojshme dhe rrjedhimisht, në zvarritje të procesit të mbrojtjes.

Kjo qasje konservatore bie ndesh me frymën e ligjit “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, i ndryshuar, i cili synon reagim të shpejtë dhe efektiv për të garantuar mbrojtjen e menjëhershme të viktimave. Zbatimi më i gjerë i kësaj dispozite do të mundësonte përshpejtimin e procedurave dhe shmangien e situatave kur viktimat mbeten për periudha të gjata pa mbrojtje ligjore për shkak të pengesave procedurale.

Nga këndvështrimi juridik, ky nen është në harmoni me parimet e Konventës së Stambollit, e cila kërkon që shtetet të sigurojnë mekanizma të menjëhershëm dhe efektivë gjyqësorë për mbrojtjen e viktimave të dhunës. Megjithatë, mungesa e zbatimit praktik tregon se nevojitet një interpretim më dinamik nga gjykatat, si dhe udhëzime të brendshme që orientojnë gjyqtarët drejt përdorimit më të shpeshtë të kësaj dispozite, sidomos në rastet ku prania fizike e palëve nuk është thelbësore për vendimmarrjen.

Në përfundim, mund të thuhet se edhe pse ligji ofron fleksibilitet procedural për të përshpejtuar gjykimin dhe për të garantuar mbrojtjen e viktimave, zbatimi i tij mbetet i kufizuar, duke reflektuar një qasje formale të sistemit gjyqësor që ende nuk e ka përvetësuar plotësisht parimin e mbrojtjes proaktive të viktimës.

Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje parashikon në nenin 13 paragrafi 4 që në rastet kur kërkesa për urdhër mbrojtjeje është paraqitur nga Policia ose Prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk ndalon gjykimin e çështjes. Ky parim është një reflektim i qartë i natyrës së veçantë dhe emergjente të rasteve të dhunës në familje, ku mbrojtja e viktimës dhe interesit publik kanë përparësi mbi vullnetin individual të tërheqjes së padisë.

Kjo dispozitë është në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e viktimave, si Konventa e Stambollit dhe normat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat theksojnë domosdoshmërinë e ndërhyrjes proaktive nga organet shtetërore për të mbrojtur viktimat e dhunës, veçanërisht në rastet kur ato janë në një pozicion të cënueshëm.

Arsyeja ligjore për një qasje të tillë është e dyfishtë: së pari, dhuna në familje është një çështje që prek interesin publik dhe shëndetin social, dhe për këtë arsye duhet trajtuar edhe në mungesë të kërkesës aktive të viktimës, së dyti, shpeshherë viktimat mund të tërhiqen.

Megjithatë, praktika gjyqësore tregon një mospërputhje të theksuar me normën ligjore. Gjatë monitorimit nuk është identifikuar asnjë rast ku policia apo prokuroria të kenë paraqitur kërkesë për lëshimin e një urdhri mbrojtjeje, edhe pse ligji ua

njuh qartë këtë kompetencë. Si pasojë, çdo kërkesë për mbrojtje vazhdon të mbështetet vetëm në iniciativën e vetë viktimës.

Arsyeja e moszbatimit mund të jetë komplekse dhe përfshin faktorë si mungesa e trajnimeve për punonjësit e policisë dhe prokurorisë mbi këtë dispozitë, mungesa e udhëzimeve dhe protokolleve të qarta për zbatimin e saj, si dhe mungesa e mekanizmave të monitorimit për respektimin e këtij parimi. Ky boshllëk ligjor dhe institucional krijon një situatë ku mbrojtja e viktimave në fakt mbetet e mangët, pavarësisht qëllimeve të ligjit.

Nga një këndvështrim juridik dhe të drejtave të individit, moszbatimi i këtij parimi është problematik dhe kërkon ndërhyrje urgjente. Duhet të vendosen mekanizma të qartë kontrolli dhe monitorimi për zbatimin e tij nga policia dhe prokuroria, të zhvillohen trajnime të specializuara dhe të krijohen protokolle standarde pune që sigurojnë vijueshmërinë e procesit edhe në rast të tërheqjes së viktimës. Vetëm një qasje e tillë mund të bëjë që ky nen të mos mbetet thjesht një dispozitë ligjore pa efekt praktik, por një mjet real mbrojtjeje për viktimat e dhunës në familje.

Kjo mungesë veprimi nga organet ligjzbatuese krijon një boshllëk serioz në mbrojtjen e viktimave, sidomos në rastet kur ato, për shkak të presionit, frikës apo varësisë ekonomike, hezitojnë ose tërhiqen nga ndjekja e çështjes që në momentin e raportimit në polici. Në mungesë të një kërkesë nga autoritetet, procesi gjyqësor nuk fillon/ vazhdon, duke bërë që mbrojtja ligjore të mbetet vetëm në letër dhe viktimat të ekspozohen sërish ndaj rrezikut.

Ky fenomen dëshmon për nevojën urgjente të forcimit të rolit aktiv të policisë dhe prokurorisë në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, si dhe të trajnimit dhe sensibilizimit të këtyre institucioneve për të përdorur mjetet që ligji u vë në dispozicion.

Në përfundim, ky nen është një instrument praktik i rëndësishëm, i cili nëse zbatohet në mënyrë konsekuente, mund të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e hetimit gjyqësor, bashkëpunimin institucional dhe mbrojtjen e efektshme të viktimave të dhunës në familje.

Dispozita e Nenit 19 paragrafi 2/1 i Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje parashikon që gjykata mund të lëshojë urdhër mbrojtjeje edhe në rastet kur palët deklarojnë se konflikti është zgjidhur ose duhet të zgjidhet përmes pajtimit ose ndërmjetësimit. Ky parim reflekton një qasje mbrojtëse dhe parandaluese ndaj dhunës, duke njohur se në situatat e dhunës në familje nuk është gjithmonë e sigurt që një marrëveshje apo “pajtim i përkohshëm” të garantojë përfundimisht sigurinë e viktimës.

Në kontekstin e dhunës në familje, ekziston rreziku i një “marrëveshjeje të detyruar”, ku viktimat mund të ndjehet të detyruar të pranojnë pajtimin për shkak të frikës, presionit ose mungesës së mbështetjes sociale dhe ligjore. Për këtë arsye, ligji ka vendosur që edhe kur ekziston një pretendim për zgjidhje me pajtim, kjo nuk e përjashton automatikisht nevojën për ndërhyrje ligjore dhe për marrjen e një urdhri mbrojtjeje.

Ky nen gjithashtu është në përputhje me standardet ndërkombëtare, si Konventa e Stambollit, që kërkon nga shtetet pjesëmarrëse të garantojnë që çdo masë mbrojtëse të jetë në interes të viktimës dhe të vendoset edhe në mungesë të dëshirës aktive të saj për të ndjekur procedurat, kur kjo është e nevojshme për sigurinë e saj.

Nga këndvështrimi juridik, kjo dispozitë i jep gjykatës një diskrecion të rëndësishëm, por edhe një përgjegjësi të madhe për të vlerësuar në mënyrë objektive situatën dhe për të vendosur në interes të mbrojtjes së viktimës, pavarësisht pretendimeve të palëve për pajtim. Në praktikë, kjo parashikon një mekanizëm që nuk lejon që çështjet e dhunës në familje të minimizohen ose të mbyllen vetëm përmes marrëveshjes së palëve, por garanton që gjykata të jetë aktor kryesor në vendosjen e masave mbrojtëse.

Ky parim është thelbësor për të siguruar që masat mbrojtëse të jenë efektive dhe të qëndrueshme, duke përmirësuar mbrojtjen ligjore të viktimave dhe duke adresuar realitetin kompleks të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Së pari, Urdhri Mbrojtës ka natyrë jo vetëm private, por edhe publike. Ai synon të parandalojë rrezikun e dhunës, kërcënimit apo cenimit të të drejtave që mund të kenë pasoja jo vetëm për palët, por edhe për rendin publik dhe shoqërinë në përgjithësi. Për këtë arsye, aktet e lëshuara në kuadër të urdhërit të mbrojtjes kanë karakter të zbatueshëm edhe pa marrë parasysh vullnetin momental të palëve, sepse interesi publik për mbrojtjen e sigurisë dhe rendit mbizotëron mbi interesin individual të heqjes dorë nga kërkesa.

Së dyti, heqja dorë nga kërkesa nga pala paditëse nuk i heq gjykatës kompetencën dhe detyrimin ligjor për të shqyrtuar rastin nëse plotësohen kushtet ligjore për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes. Në rast se rrethanat e faktit tregojnë një rrezik real dhe të menjëhershëm për shkeljen e të drejtave të mbrojtura me urdhër mbrojtje, gjykata nuk mund të ndalet vetëm në bazë të heqjes dorë të paditësit, pasi një veprim i tillë do të cenonte parimin e drejtësisë dhe sigurisë.

Së treti, edhe kur palët pretendojnë se konflikti është zgjidhur ose do të zgjidhet përmes ndërmjetësimit, gjykata ka detyrimin të verifikojë në mënyrë të pavarur nëse kjo marrëveshje ose zgjidhje është reale, e ligjshme dhe e qëndrueshme. Nëse ka indicie se situata mund të rrezikojë përsëri shkelje të të drejtave apo dhunë, gjykata mund të vendosë që të lëshojë urdhërin e mbrojtjes për të parandaluar dëme të mëtejshme. Kjo qasje ruan parimin e mbrojtjes së të drejtave dhe sigurisë, duke mos e lënë vend vetëm për marrëveshjet midis palëve që mund të jenë të paqëndrueshme ose të përkohshme.

Në përfundim, vendimi i gjykatës për të lëshuar urdhrin mbrojtës pavarësisht heqjes dorë nga pala paditëse ose pretendimeve për zgjidhje me ndërmjetësim është i bazuar në nevojën për të mbrojtur interesin publik, rendin dhe sigurinë, si dhe për të garantuar zbatimin efektiv të të drejtave ligjore të viktimave. Kjo qasje siguron që sistemi i drejtësisë të mos mbetet pasiv ndaj rasteve ku mund të ketë rrezik për

shkelje të drejtave, duke i dhënë kështu rëndësi të veçantë mbrojtjes së drejtësisë dhe sigurisë në shoqëri.

Megjithatë, analiza e praktikës gjyqësore gjatë monitorimit tregon se kjo dispozitë përdoret shumë rrallë, duke u zbatuar vetëm në një rast nga i gjithë numri i çështjeve të shqyrtuara. Ky tregues është shqetësues sepse tregon një boshllëk në zbatimin e legjislacionit, pavarësisht rëndësisë së këtij mekanizmi për mbrojtjen e viktimave në situata të veçanta. Arsyeja e kësaj mungese përdorimi mund të jetë lidhur me mungesën e njohurive të gjyqtarëve për këtë dispozitë, mungesën e praktikave të standardizuara për zbatimin e saj, ose një perceptim që çështjet e pajtimit nuk paraqesin nevojë urgjente për masë mbrojtëse.

Ky realitet është i rëndësishëm për analizën ligjore sepse tregon një diferencë mes parimit të përcaktuar në ligj dhe praktikës së zbatimit. Nga një këndvështrim juridik, kjo situatë kërkon ndërhyrje për forcimin e trajnimeve për gjyqtarët dhe zhvillimin e udhëzimeve konkrete për përdorimin e nenit 19 paragrafi 2/1 të ligjit Vetëm përmes një angazhimi të tillë mund të sigurohet që kjo dispozitë të mos mbetet në letër, por të shndërrohet në një instrument real dhe efektiv mbrojtës në shërbim të viktimave të dhunës në familje.

Në këtë mënyrë, përdorimi më i gjerë i këtij neni jo vetëm që do të përmirësonte mbrojtjen ligjore, por edhe do të përforconte qëndrueshmërinë e masave mbrojtëse në raste ku palët tentojnë të zgjidhin konfliktin përmes pajtimit ose ndërmjetësimi, duke garantuar që ky proces të mos bëhet në kurriz të sigurisë dhe të drejtave të viktimave.

Këto probleme nënvizojnë nevojën e domosdoshme për forcimin e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, për përgatitjen e vendimeve me bazë të fortë provash dhe arsyetim të plotë, si dhe për përfshirjen më sistematike të standardeve ndërkombëtare në proceset gjyqësore për dhunën në familje. Kjo është e domosdoshme për të garantuar një drejtësi të efektshme, të drejtë dhe të besueshme.

E) GJYKIMI BRENDË NJË AFATI TË ARSYESHËM

Një element tjetër themelor i përfshirë në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së ka të bëjë me të drejtën për proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm. Kushti që afatet proceduriale të jenë të arsyeshme është i një rëndësie parësore.

Koncepti i një "afati kohor të arsyeshëm" është një kriter që mund të variojë në bazë të faktit nëse kemi të bëjmë me çështje civile apo penale. Në këtë pikë jurisprudenca ka sqaruar se një organikë e papërshtatshme ose probleme

administrative më të përgjithshme nuk mund të justifikojnë shkeljen e parimit të një afati të arsyeshëm të një procesi. Duhet të merren parasysh edhe faktorët e tjerë, si kompleksiteti i çështjes, ajo çfarë rrezikon ankuesi, sjellja e autoriteteve, të cilët duhet të bëjnë gjithçka që është e mundur për të mënjeluar një vonesë në proces si dhe sjellja eventuale e ankuesit i cili mund të bashkëpunojë me organet e drejtësisë ose mund të krijojë pengesa.

Lëshimi i Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes është një proces që kryhet në mënyrë imediate, pra brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës për një të mitur dhe 48 orëve nga parashtrimi i kërkesës për një të rritur, dhe ky urdhër lëshohet nëse gjykata konstaton se kërcënimi i dhunuesit mbi viktimën është i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm për sigurinë shëndetin apo mirëqenien e tij/saj. Data e dëgjimit për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, është brenda 20 ditësh prej lëshimit të tij me vendim gjykate.

Në bazë të nenit 16 të ligjit “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, i ndryshuar “Gjykata vendos shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës”.

Nga të dhënat e monitorimit rezulton se këto afate ligjore në lidhje me trajtimin e kërkesave për urdhër mbrojtjeje respektohen në një masë të madhe, ku në 96 % të rasteve shqyrtimi gjyqësor fillon dhe përfundon brenda periudhës së parashikuar ligjore, ku mesatarisht shqyrtimi gjyqësor për këto çështje përfundon 12 ditë pas depozitimit të kërkesë-padisë.

Kjo përputhje e rregullt me afatet ligjore është një tregues pozitiv që reflekton angazhimin e sistemit gjyqësor për të garantuar mbrojtjen efektive të viktimave, duke vepruar me shpejtësi dhe efikasitet në situatat e rrezikut të menjëhershëm. Respektimi i këtyre afateve është i rëndësishëm për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të viktimave dhe për të siguruar që masat mbrojtëse të hyjnë në fuqi sa më shpejt.

Për më tepër, respektimi i afateve ligjore ndihmon në rritjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor dhe kontribuon në një trajtim më të drejtë dhe profesional të rasteve të dhunës në familje.

II.4 ANALIZË E KOHEZGJATJES SË URDHËRAVE TË MBROJTJES

Në total, janë monitoruar 170 vendime të urdhërave të mbrojtjes me kohezgjatje të ndryshme, të shpërndara si më poshtë:

Kohezgjatja (muaj)	Numri i rasteve	Përqindja (%)
1	3	2%
2	3	2%
3	23	13%
4	6	4%
5	2	1%
6	51	30%
7	1	0.5%
8	1	0.5%
9	2	1%
12	78	46%

Në total janë regjistruar 170 raste të urdhrave të mbrojtjes me kohezgjatje të ndryshme, të cilat shpërndahen në mënyrë të dallueshme sipas kohëzgjatjes. Nga analiza e të dhënave, vihet re një dominim i periudhave të gjata, sidomos ato prej 6 dhe 12 muajsh. Konkretisht, 51 raste (30%) përfshijnë periudha prej 6 muajsh, ndërsa 78 raste (46%) zgjaten deri në 12 muaj, duke përbërë së bashku një përqindje prej 76% të totalit. Ky trend tregon se shumica e urdhrave të mbrojtjes vendosen për një kohëzgjatje të konsiderueshme, duke reflektuar nevojën për mbrojtje të qëndrueshme dhe parandalim afatgjatë të dhunës.

Periudha më të shkurtra (1–3 muaj) përbëjnë vetëm 17% të rasteve, dhe në veçanti vetëm 4% e rasteve janë me kohezgjatje më të shkurtër, që tregon se është relativisht më e rrallë që urdhëri i mbrojtjes të përfundojë brenda një intervali kaq të shkurtër. Një pjesë e këtyre rasteve mund të lidhet me situata emergjente apo të përkohshme, ku rreziku mund të eliminohet shpejt ose ku ndërhyrjet e tjera mbrojtëse bëjnë të mundur mbylljen e shpejtë të masës.

Nga këndvështrimi juridik, kohëzgjatja e urdhërit të mbrojtjes duhet të jetë e balancuar mes nevojës për mbrojtje efektive të viktimës dhe respektimit të të drejtave të palës tjetër, në këtë rast të dhunuesit. Vendosja e periudhave të gjata reflekton një qasje parandalimi, duke synuar që viktima të jetë e mbrojtur për një kohë të mjaftueshme, sidomos kur ekziston rrezik i vazhdueshëm ose kur dhuna ka karakter të përsëritur. Një urdhër mbrojtjeje me kohëzgjatje të konsiderueshme përputhet me standardet ndërkombëtare, përfshirë Konventën e Stambollit, e cila thekson nevojën për masa mbrojtëse që të jenë efektive dhe në kohëzgjatje të mjaftueshme për të parandaluar dhunën në familje.

Megjithatë, kohezgjatja e madhe e urdhërit të mbrojtjes duhet të argumentohet me prova dhe vlerësim të situatës konkrete, për të shmangur një kufizim të panevojshëm të të drejtave të dhunuesit. Për këtë arsye, vendimet gjyqësore duhet të mbështeten në një analizë të detajuar të riskut dhe të provave, duke pasur

parasysh edhe rekomandimet e vlerësimeve sociale dhe psikologjike. Një qasje e tillë siguron një ekuilibër mes mbrojtjes së viktimës dhe respektimit të parimeve të drejtësisë dhe proporcionalitetit.

Nga një këndvështrim praktik, periudhat e gjata të urdhërave të mbrojtjes mund të kenë përfitime të rëndësishme, pasi krijojnë një hapësirë kohore për ndërhyrje të tjera mbrojtëse, si trajtime rehabilituese për dhunuesin, mbështetje sociale dhe psikologjike për viktimën, si dhe monitorim policor. Një kohezgjatë më e madhe rrit gjithashtu efektin paralajmërues ndaj dhunuesve të tjerë dhe forcon sigurinë në komunitet.

Nga ana tjetër, duhet të merret parasysh se periudha të gjata mund të krijojnë sfida praktike, si nevoja për burime shtesë për zbatim, monitorim të vazhdueshëm dhe koordinim ndërinstitutional, si dhe rritje e barrës administrative për sistemin gjyqësor. Për këtë arsye, është e nevojshme që vendosja e kohëzgjatjes së urdhërave të mbrojtjes të jetë e bazuar në një proces të strukturuar vlerësimi të rrezikut dhe të mbështetur nga protokolle të qarta ligjore.

Në përfundim, analiza e shpërndarjes së kohëzgjatjes së urdhërave të mbrojtjes tregon një tendencë të fortë drejt periudhave të gjata, që reflekton një strategji mbrojtjeje dhe parandalimi më të qëndrueshëm. Një qasje e tillë është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ofron një mbështetje më të madhe për viktimat. Megjithatë, kjo duhet të bëhet duke ruajtur një balancë ligjore dhe duke siguruar që çdo vendim të jetë i individualizuar dhe i argumentuar në mënyrë të plotë për të garantuar drejtësi për të gjitha palët e përfshira.

II.5 REAGIMI INSTITUCIONAL DHE MASAT MBROJTËSE

Masa e vendosur	Numri	Përqindja (%)
Referim për ndjekje penale	6	5 %
Largim nga banesa	34	27 %
Ndalohet komunikimi në rrjete sociale	13	10 %
Programe rehabilitimi për dhunuesin	42	34%
Sekuestrim armësh	2	1.5%
Ndihmë sociale / shërbime komunitare	17	13.5%
Pension ushqimor	1	1%
Strehë për viktimën	5	4%
Monitorim i UM nga policia	5	4%

Masat mbrojtëse të caktuara nga gjykata në vendimet objekt monitorimi reflektojnë një kombinim të përdorimit të mekanizmave ligjorë, mbështetjes sociale dhe parandalimit të dhunës në familje. Analiza e tyre mund të bëhet në kuadër të legjislacionit dhe praktikave ndërkombëtare për mbrojtjen e viktimave.

Ligji nr.9669 datë 18.12.2006 “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, i ndryshuar përcakton një gamë masash mbrojtëse, ndër të cilat masa e largimit nga banesa përbën një nga instrumentet më të rëndësishme. Neni 10 i këtij ligji parashikon qartë se gjykata ka kompetencë dhe detyrim të urdhërojë largimin e dhunuesit nga banesa për një afat të caktuar kur viktima dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë. Kjo masë emergjente synon të sigurojë mbrojtjen e menjëhershme të viktimës duke eliminuar mundësinë e kontaktit fizik dhe ndikimit të dhunuesit, dhe është një nga mënyrat më efektive për të parandaluar përkeqësimin e situatës. Ligji kërkon gjithashtu që gjykata, kur vendos për këtë masë, të marrë në konsideratë nevojat e veçanta të dhunuesit, nëse ky është person i mitur, i moshuar apo me aftësi të kufizuara, dhe të aplikojë masën vetëm kur nuk ka alternativa të tjera që garantojnë mbrojtjen e viktimës.

Megjithatë, analiza e të dhënave tregon se përdorimi i masës së largimit nga banesa është relativisht i ulët krahasuar me numrin real të rasteve që mund të plotësojnë kushtet ligjore për aplikimin e saj. Në të dhënat e mbledhura, largimi nga banesa përbën 27 % të masave të zbatuara nga gjykata, një nivel që, megjithëse i lartë në krahasim me disa masa të tjera, reflekton një hendek mes kërkesave ligjore dhe praktikës së zbatimit.

Edhe pse masa e largimit të dhunuesit nga banesa është ndër mjetet më të rëndësishme për garantimin e sigurisë së viktimës, në praktikë konstatohet se gjykatat shpesh kur nuk e aplikojnë këtë masë, nuk japin një arsyetim të qartë dhe të bazuar ligjorisht për moszbatimin e saj. Ligji parashikon raste të veçanta kur kjo masë mund të mos merret, si kur autori është i mitur, i moshuar në varësi të kujdesit të viktimës, apo ka aftësi të kufizuara që e bëjnë largimin të pamundur ose të pajustificueshëm. Megjithatë, në shumicën e vendimeve gjyqësore, nuk jepet asnjë analizë apo referencë ndaj këtyre përjashtimeve ligjore, dhe mungon vlerësimi i qartë nëse ekzistojnë ose jo rrethana që e justifikojnë mosmarrjen e kësaj mase.

Kjo mungesë e arsytimit jo vetëm që çënon transparencën dhe llogaridhënien e gjykatës, por gjithashtu pengon kontrollin efektiv të vendimit si nga palët, ashtu edhe nga institucionet mbikëqyrëse apo strukturat e apelit. Për më tepër, një vendim i pambështetur në një analizë të hollësishme të situatës rrezikon të dëmtojë sigurinë e viktimës dhe të lërë të papërmbytur funksionin mbrojtës të ligjit.

Përveç largimit nga banesa, legjislacioni parashikon masa të tjera mbrojtëse që synojnë të adresojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse fenomenin e dhunës në familje. Referimi për ndjekje penale është një mekanizëm themelor për sanksionimin e

dhunuesve dhe për të garantuar përgjegjësinë ligjore, por përdorimi i tij është i kufizuar, vetëm në 5% e rasteve, duke sugjeruar se shpesh mungon denoncimi apo prova e mjaftueshme për fillimin e procedurave penale. Ndalimi i komunikimit në rrjete sociale përbën një masë emergjente që reflekton sfidat e reja ligjore për dhunën digjitale, por përdorimi i saj është gjithashtu i kufizuar në 10%, duke treguar nevojën për forcimin e protokolleve ligjore në këtë fushë.

Masat që përfshijnë programe rehabilitimi për dhunuesin janë më të përdorurat, me 34% të rasteve, duke u shndërruar në një element thelbësor të strategjive të parandalimit të dhunës. Kjo qasje përputhet me praktikat më të mira ndërkombëtare, duke synuar ndryshimin e sjelljes së dhunuesit dhe uljen e riskut për përsëritje të veprës. Ndiham sociale dhe shërbimet komunitare përdoren në 13.5% të rasteve dhe kanë për qëllim mbështetjen e viktimave në aspektin ekonomik, social dhe psikologjik, duke krijuar një rrjet sigurie që shtrihet përtej reagimit emergjent.

Masat si sekuestrimi i armëve (1.5%), pensioni ushqimor (1%), strehë për viktimën (4%) dhe monitorimi nga policia (4%) përdoren më rrallë, megjithëse secila prej tyre ka një rol të veçantë në mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës. Sekuestrimi i armëve është një masë me rëndësi kritike për sigurinë fizike, ndërsa strehimi ofron mbrojtje emergjente për viktimat në rrezik të menjëhershëm. Pensioni ushqimor përbën një mbështetje ekonomike të drejtpërdrejtë, ndërsa monitorimi policor forcon zbatimin e masave dhe siguron kontrollin mbi sjelljen e dhunuesit.

Në përfundim, analiza tregon se masat mbrojtëse që parashikon ligji shqiptar për dhunën në familje janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, por zbatimi i tyre në praktikë shpesh është i mangët. Hendekët mes ligjit dhe praktikës kërkojnë përmirësime të thella në zbatim, përfshirë forcimin e mekanizmave urgjent për largim nga banesa, rritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe policisë, trajnime të specializuara, si dhe krijimin e një koordinimi më efikas ndërinstitutional. Vetëm një qasje gjithëpërfshirëse dhe efektive mund të sigurojë mbrojtje reale për viktimat dhe të përmirësojë zbatimin e parimit ligjor të mbrojtjes ndaj dhunës në familje.

Reagimi institucional në rastet e dhunës në familje duhet të jetë gjithëpërfshirës, duke kombinuar masa ndaluese me masa mbrojtëse dhe programe rehabilituese për dhunuesit, si dhe me mbështetje sociale për viktimat. Ndjekja penale duhet të integrohet më mirë me procedurat civile të urdhrave të mbrojtjes për të garantuar përgjegjësinë ligjore dhe mbrojtjen efektive. Monitorimi i vazhdueshëm nga policia dhe institucionet relevante është thelbësor për parandalimin e recidivës dhe sigurinë e viktimave.

Investimi në shërbime sociale dhe trajnime profesionale për të gjithë aktorët e përfshirë do të rrisë cilësinë e përgjigjes institucionale ndaj dhunës në familje dhe do të ndihmojë në ndërtimin e një sistemi më efektiv mbrojtjeje dhe parandalimi.

II.6 PJESËMARRJA E INSTITUCIONEVE NE PROCES

Sipas nenit 13 paragrafi 8 të ligjit “Gjykata, për nevoja të gjykimit, mund të thërrasë përfaqësuesin e Policisë së Shtetit dhe/ose koordinatorin vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, të paraqiten në seancë gjyqësore për të dhënë shpjegime.”

Ky nen i ligjit “*Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, i ndryshuar, përbën një mekanizëm të rëndësishëm për sigurimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe për forcimin e bazës provuese në proceset gjyqësore që lidhen me dhunën në familje. Ai i jep gjykatës kompetencën të thërrasë përfaqësues të policisë së Shtetit dhe/ose koordinatorin vendor për referimin e rasteve të dhunës, me qëllim që të japin sqarime dhe informacion shtesë mbi rrethanat e rastit, dinamiken e dhunës dhe masat e ndërmarra parapraakisht.

Kjo dispozitë ka një rol thelbësor në garantimin e vërtetësisë së fakteve dhe në përforcimin e mbrojtjes së viktimave, pasi përfaqësuesit institucionalë janë shpesh ndër të parët që kanë kontakt me rastin dhe mund të ofrojnë prova ose të dhëna të rëndësishme për vlerësimin e gjykatës. Thirrja e tyre në seancë gjyqësore ndihmon gjithashtu në identifikimin e rasteve të përsëritura të dhunës, në verifikimin e zbatimit të masave të mbrojtjes dhe në evidentimin e rasteve kur strukturat e rendit apo sociale nuk kanë ndërhyrë me kohë.

Megjithatë, në praktikë kjo dispozitë zbatohet shumë rrallë. Nga analizat e vendimeve gjyqësore rezulton se në shumicën e rasteve gjykatat nuk thërrasin përfaqësues të policisë apo koordinatorin vendor, edhe kur kjo do të ishte e domosdoshme për të sqaruar rrethanat e dhunës. Kjo tregon një mungesë bashkëveprimi të qëndrueshëm ndërmjet gjykatave dhe institucioneve mbështetëse, çka ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e arsyetimit gjyqësor dhe në efektivitetin e mbrojtjes së viktimës.

Është konstatuar se pjesëmarrja e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në proceset gjyqësore është shumë e kufizuar. Nga një total prej 173 rastet e shqyrtuara, vetëm 4 përfaqësues institucionalë kanë marrë pjesë në gjykim, çka përbën një pjesëmarrje shumë të ulët dhe shqetësuese. Pra në më pak se 2.5% të rasteve përfaqësuesit e institucioneve kanë marrë pjesë në gjykim.

Zbatimi më i gjerë i këtij neni do të mundësonte rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale, duke krijuar një praktikë më gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në bashkëpunim real ndërmjet policisë, gjykatave dhe strukturave të mbrojtjes sociale. Për këtë arsye, rekomandohet që gjykatat të aplikojnë më shpesh

këtë dispozitë, sidomos në rastet kur mungon prova e drejtpërdrejtë ose kur nevojitet verifikim i zbatimit të urdhrave të mëparshëm të mbrojtjes.

Kjo situatë ngre shqetësime serioze lidhur me efektivitetin e mbrojtjes institucionale të të drejtave të viktimave dhe garantimin e drejtësisë në përgjithësi. Institucionet shtetërore kanë një rol kyç në mbrojtjen e rendit publik dhe sigurimin e përfaqësimit ligjor dhe mbështetjes për palët më të dobëta në procese gjyqësore. Pjesëmarrja e kufizuar e tyre rrezikon të dobësojë këto funksione, duke lënë viktimat të pambrojtura ose të përfaqësuara në mënyrë të pamjaftueshme.

Për më tepër, mungesa e angazhimit të institucioneve në këto procese mund të ndikojë negativisht në besimin e qytetarëve tek sistemi i drejtësisë dhe të dëmtojë perceptimin e përgjithshëm për barazinë para ligjit dhe zbatimin efektiv të të drejtave.

Në procesin gjyqësor për rastet që përfshijnë viktima, pjesëmarrja e përfaqësuesve institucionalë ka një rëndësi të madhe jo vetëm për përfaqësimin e palëve, por edhe për sigurimin e provave dhe informacionit relevant që këto institucione posedojnë. Komisaritet, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe struktura të tjera shtetërore, mbajnë në zotërim dokumente, raporte, dëshmi dhe të dhëna të cilat janë të domosdoshme për sqarimin e plotë të çështjes dhe marrjen e një vendimi të drejtë.

Prandaj, është thelbësore që institucionet të angazhohen më shumë në rolin e tyre aktiv, duke siguruar praninë e përfaqësuesve të autorizuar në gjykim, të cilët jo vetëm që përfaqësojnë institucionet, por edhe sjellin provat dhe informacionet që disponojnë.

KREU III

PROFILI SOCIO-EKONOMIK DHE ARSIMOR I VIKTIMAVE DHE DHUNUESVE

III.1 DIMENSIONI GJINOR I DHUNËS NË FAMILJE

Në analizën e 173 vendimeve të pranuar për urdhërat e mbrojtjes në çështjet civile të dhunës në familje, janë evidentuar një sërë treguesish të rëndësishëm që ndihmojnë në kuptimin e dinamikës së rasteve dhe mënyrës së reagimit institucional ndaj tyre. Në total, janë regjistruar 176 viktima, çka tregon se në disa vendime janë përfshirë më shumë se një person si viktimë, duke reflektuar kompleksitetin e rasteve të dhunës familjare, ku shpesh preken njëkohësisht gra, fëmijë apo anëtarë të tjerë të familjes. Kjo nënvizon nevojën për një qasje më gjithëpërfshirëse të mbrojtjes, ku përveç dhunës ndaj partnerit, të adresohen edhe pasojat e saj tek anëtarët e tjerë të familjes.

Në mënyrë të përgjithshme, këto të dhëna ofrojnë një pasqyrë të rëndësishme mbi funksionimin praktik të sistemit të urdhërave të mbrojtjes, duke treguar se ndonëse ligji ofron instrumente të qarta për mbrojtjen e viktimave, sfida mbetet në zbatimin efektiv dhe në koordinimin ndërinstitutional, që shpesh mungon në praktikë.

Nga analiza e të dhënave mbi autorët e dhunës në familje, vihet re një pabarazi e dukshme gjinore, që përputhet me tendencat e përgjithshme të dhunës në familje në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Viktimat gra/vajza përbëjnë shumicën dërrmuese, me 148 raste (84 %), duke konfirmuar se dhuna në familje mbetet kryesisht një fenomen me bazë gjinore, ku gratë janë më shpesh subjekt i dhunës fizike, psikologjike, seksuale apo ekonomike.

Viktimat meshkuj janë 28 raste (16 %), një përqindje më e ulët, por që tregon se edhe burrat mund të jenë viktima të dhunës familjare.

Nga ana tjetër, për sa i përket autorëve të dhunës:

- Dhunuesit meshkuj përbëjnë 93% (164 raste), duke reflektuar dominimin e këtij grupi në raportet e dhunës familjare.
- Dhunueset gra/vajza, megjithëse në numër më të vogël 12 raste, ose 7%, tregojnë se fenomeni nuk është tërësisht njëkahësh dhe se mund të ketë situata ku dhuna ushtronet nga gratë/ vajzat, shpesh në kontekste të ndërlikuara marrëdhëniesh familjare apo në raste mbrojtjeje ndaj dhunës së përsëritur.

Këto të dhëna nënvizojnë qartë karakterin gjinor të dhunës në familje, ku gratë dhe vajzat mbeten më të ekspozuara ndaj dhunës, ndërsa burrat dominojnë në rolin e dhunuesit. Megjithatë, ato gjithashtu tregojnë nevojën për qasje gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme gjinore në trajtimin e rasteve, për të garantuar mbrojtje efektive për çdo viktimë, pavarësisht gjinisë.

Faktori dominues i meshkujve si dhunues (93 %) dhe grave/ vajzave si viktimë (84%) përkon me modelet globale të dhunës në familje, duke reflektuar normat patriarkale të shoqërisë shqiptare. Kjo tregon jo vetëm se dhuna është e lidhur ngushtë me strukturat e fuqisë gjinore, por edhe sfidat në adresimin e saj në sistemin ligjor dhe shoqëror.

Pabarazia gjinore e evidentuar në këtë studim kërkon nga institucionet ligjzbatuese dhe gjyqësore të përforcojnë kapacitetet e tyre për trajtim të ndjeshëm gjinor, duke siguruar që çdo rast të trajtohet me respekt të të drejtave të njeriut dhe duke mbrojtur integritetin fizik dhe psikologjik të viktimave. Është thelbësore që politikat sociale dhe ligjore të përqendrohen në luftimin e normave dhe stereotipeve diskriminuese, të cilat thellojnë pabarazinë dhe pengojnë aksesin e viktimave në drejtësi.

Nga ana tjetër, viktimat meshkuj, që përbëjnë 16% të totalit, shpesh përballen me stigmatizim dhe mungesë shërbimesh të dedikuara, që çon në nënraportim dhe pamundësi për mbrojtje efektive. Ligji dhe institucionet duhet të zhvillojnë politika gjithëpërfshirëse, duke njohur dhe adresuar nevojat specifike të të gjitha viktimave, pavarësisht nga gjinia, duke respektuar parimin e barazisë dhe të drejtave të njeriut.

Në përfundim, përballja efektive me fenomenin e dhunës në familje kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, e bazuar në respektimin e të drejtave themelore dhe parimeve të barazisë gjinore. Kjo përfshin zbatimin e ligjit në mënyrë efikase dhe gjithëpërfshirëse, përmirësimin e kapaciteteve institucionale, si dhe promovimin e ndërgjegjësisë dhe edukimit për ndryshimin e normave shoqërore diskriminuese.

III.2 SUBJEKTET E PËRFSHIRA NË DHUNË

Marrëdhënia	Numri	Përqindja (%)
Bashkëshortë	63	37%
Fëmijë – prind	36	21%
Motër – vëlla	17	10%
Kunetër	10	6%
Ish-bashkëshortë	10	6%
Bashkëjetues	9	5%

I dashur	7	4%
Ish i dashur	6	4%
Vjehërr – nuse	6	4%
Xhaxha – nip	4	3%
Totali	172	100%

Nga të dhënat e mësipërme del qartë se forma më e përhapur e dhunës në familje mbetet ajo bashkëshortore, e cila përbën rreth 37% të rasteve. Kjo përqindje e lartë reflekton problematikën e vazhdueshme të dhunës në marrëdhëniet martesore, e cila shpesh shfaqet si pasojë e varësisë ekonomike, kontrollit emocional, xhelozisë apo mungesës së mekanizmave të hershëm ndërhyrës.

Një përqindje e konsiderueshme 21 %, i përket marrëdhënieve prind-fëmijë dhe fëmijë- prind, çka është tregues alarmues për dhunën e ushtruar ndaj të miturve, apo edhe të kundërtën në disa raste. Kjo kërkon zbatim më të fortë të Ligjit nr. 9669/2006 “*Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, i ndryshuar, që i jep gjykatës kompetencën për të parashikuar masa mbrojtëse për fëmijët që kanë qenë të pranishëm apo viktimë të dhunës së asistuar. Megjithatë, zbatimi i kësaj dispozite vërehet ende i kufizuar në praktikë.

Në 10 % të rasteve dhuna ndodh midis motrës dhe vëllait, ndërsa 6% përfshijnë kunetër dhe po aq ish-bashkëshortë, duke treguar se fenomeni i dhunës shtrihet edhe përtej marrëdhënieve bashkëshortore, duke prekur strukturën e familjes së gjerë.

Rastet e bashkëjetuesve (5%), të dashurve (4%) dhe ish-të dashurve (4%) nxjerrin në pah nevojën për interpretim të zgjeruar të konceptit të “marrëdhënieve familjare”, sipas ligjit shqiptar dhe praktikës gjyqësore, në përputhje me Konventën e Stambollit, e cila kërkon mbrojtje edhe në marrëdhënie të ngjashme me bashkëjetesën.

Dhuna midis vjehrrës dhe nuses (4%), si dhe xhaxhait dhe nipit (3%), tregon se ky fenomen ka rrënjë të forta kulturore dhe strukturore, që kërkojnë ndërhyrje sociale dhe sensibilizim komunitar përtej masave ligjore.

Të dhënat tregojnë qartë se dhuna në familje në Shqipëri është një fenomen shumëdimensional, që prek marrëdhënie të ndryshme brenda dhe jashtë bërthamës familjare.

Ndërhyrjet duhet të jenë:

- ligjore dhe efektive (përmes zbatimit rigoroz të urdhërave të mbrojtjes dhe dispozitave për të miturit);

- sociale dhe rehabilituese (përmes programeve për edukim, ndërgjegjësim dhe riintegrim);
- dhe institucionale, duke forcuar bashkëpunimin midis gjykatës, policisë, prokurorisë dhe shërbimeve sociale.

Në përmbledhje, shpërndarja gjinore dhe familjare e subjekteve të dhunës tregon se sfidat e adresimit ligjor dhe social të dhunës në familje janë komplekse dhe kërkojnë masa integruese dhe të koordinuara midis institucioneve juridike, sociale dhe komunitare. Një qasje e tillë do të ndihmojë në përmirësimin e mbrojtjes së viktimave dhe parandalimin e dhunës në të gjitha format dhe marrëdhëniet familjare.


III.3 ARSIMI

Analiza e nivelit arsimor të viktimave dhe dhunuesve në rastet e dhunës në familje ofron një pasqyrë të rëndësishme mbi faktorët shoqërorë që ndikojnë në këtë fenomen. Nga të dhënat rezulton se shumica e viktimave (rreth 70%) kanë arsim të mesëm ose të lartë, nga këto 37% zotërojnë arsim të mesëm dhe 33% arsim të lartë. Kjo tregon se dhuna në familje nuk është e kufizuar vetëm tek individët me nivel të ulët arsimor, por është një fenomen që mund të prekë të gjitha shtresat shoqërore. Një interpretim i mundshëm është se individët me arsim të ulët arsimor përballen me barriera strukturore dhe kulturore që pengojnë denoncimin apo largimin nga marrëdhëniet abuzive. Faktorë si varësia emocionale, presioni shoqëror, frika për stigmatizim, mungesa e mbështetjes së sistemit social dhe pasiguria ekonomike mund të kenë rol vendimtar në këtë situatë.

Nga ana tjetër, niveli arsimor i dhunuesve tregon një trend të qartë ku shumica e tyre (rreth 57%) kanë arsim bazë ose të ulët. Konkretisht, 43 % kanë arsim 8-vjeçar dhe 14 % arsim fillor. 29 % e dhunuesve kanë arsim të mesëm. Vetëm një përqindje e vogël e dhunuesve (14 %) kanë arsim të lartë. Ky tregues sugjeron një lidhje të fortë mes mungesës së edukimit formal dhe predispozitës për të ushtruar dhunë në marrëdhëniet familjare. Njohja e ligjit, zhvillimi i aftësive të komunikimit, menaxhimi i konflikteve dhe kultivimi i vlerave të respektit në marrëdhënie janë elementë që lidhen ngushtë me nivelin arsimor. Mungesa e tyre mund të kontribuojë në përsëritjen e modeleve të dhunës dhe në mosnjohjen e pasojave juridike dhe morale të këtyre akteve. Dhunuesit kanë në përgjithësi nivel arsimor më të ulët se

viktimat, që mund të lidhet me faktorë si mungesa e aftësive sociale, varfëria, papunësia apo ekspozimi ndaj kulturës patriarkale.

Ky diferencim në nivelin arsimor ka implikime të rëndësishme në kontekstin social dhe juridik. Arsimi i ulët të dhunuesit lidhet shpesh me mungesën e aftësive sociale, mundësive të kufizuara për punësim dhe rritjen e varfërisë, që janë faktorë të njohur risku për shfaqjen e sjelljeve të dhunshme. Nga ana tjetër, viktimat që kanë një nivel më të lartë arsimor, shpesh përballen me sfida të ndryshme në raport me statusin e tyre socio-ekonomik dhe mund të kenë pritshmëri më të larta për drejtësi dhe mbrojtje ligjore.



Ky dallim në nivelin arsimor midis viktimave dhe dhunuesve ka implikime të rëndësishme për politikat dhe praktikën ligjore. Për viktimat, pavarësisht arsimimit të tyre, ekziston nevoja për sisteme mbrojtëse më efektive dhe për programe të fuqizimit ekonomik dhe social, të cilat mund të reduktojnë varësinë dhe të ofrojnë alternativa reale për largimin nga dhuna. Për dhunuesit, është thelbësore të zhvillohen programe edukative dhe rehabilituese që adresojnë jo vetëm pasojat ligjore, por edhe dimensionin kulturor dhe edukativ të dhunës. Trajnimi mbi respektin në marrëdhënie, menaxhimin e emocioneve dhe njohjen e të drejtave themelore mund të shërbejë si një mekanizëm i fuqishëm parandalues.

Nga këndvështrimi studimor, këto të dhëna theksojnë nevojën për një qasje të integruar dhe multidimensionale ndaj fenomenit të dhunës në familje. Ajo nuk mund të trajtohet vetëm si një çështje ligjore, por duhet të shikohet si një problem social dhe kulturor që kërkon ndërhyrje në nivele të ndryshme: edukimi, politika sociale, mekanizmat ligjorë dhe ndërgjegjësimi publik. Analiza e nivelit arsimor tregon se investimi në edukim dhe në programe për ndërgjegjësimin dhe ndryshimin e modeleve të sjelljes është një hap kyç për uljen afatgjatë të incidencës së dhunës në familje.

Në aspektin juridik, ky profil socio-ekonomik dhe arsimor kërkon nga institucionet e drejtësisë dhe të shërbimeve sociale të marrin parasysh këto faktorë kur hartojnë politika mbrojtëse dhe programe rehabilitimi. Për shembull, është e nevojshme të zhvillohen programe të specializuara që adresojnë nevojat e dhunuesve me arsim dhe status socio-ekonomik të ulët, duke përfshirë trajnime për aftësi sociale dhe punësim. Në të njëjtën kohë, duhet të forcohet mbështetja për viktimat, duke siguruar akses në shërbime sociale dhe juridike të përshtatura me profilin e tyre.

Kjo qasje gjithëpërfshirëse kontribuon në parandalimin e dhunës dhe forcimin e sundimit të ligjit, duke respektuar parimet e barazisë sociale dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, siç janë përcaktuar në legjislacionin kombëtar dhe instrumentet ndërkombëtare që Shqipëria ka ratifikuar.

Për sistemin gjyqësor dhe institucionet e mbrojtjes sociale, këto gjetje kanë rëndësi të veçantë. Ato sugjerojnë nevojën për politika të integruara që nuk fokusohen vetëm në ndëshkimin penal, por edhe në parandalimin përmes arsimit, punësimit dhe fuqizimit ekonomik të individëve. Ndërhyrjet duhet të synojnë rehabilitimin dhe edukimin e dhunuesve përmes programeve të trajnimit profesional dhe këshillimit psikosocial, ndërsa për viktimat duhet garantuar mbështetje ligjore dhe ekonomike që u mundëson të ndërtojnë pavarësi dhe siguri afatgjatë.

Në përfundim, lidhja ndërmjet arsimit, statusit ekonomik dhe dhunës është e qartë: sa më i ulët niveli i arsimit dhe stabilitetit ekonomik, aq më i lartë është rreziku për sjellje dhunuese. Prandaj, përveç masave ligjore, një strategji efektive kundër dhunës në familje duhet të përfshijë investime në arsim, punësim dhe zhvillim social, pasi vetëm nëpërmjet barazisë arsimore dhe ekonomike mund të reduktohen në mënyrë të qëndrueshme format e dhunës dhe të garantohet një mbrojtje reale për viktimat.

III.4 STATUSI I PUNËSIMIT


Kur analizohen të dhënat mbi statusin e punësimit të viktimave dhe dhunuesve në rastet e dhunës në familje, del një pamje shqetësuese mbi mungesën e informacionit për këtë element në vendimet gjyqësore. Nga të dhënat e disponueshme rezulton se vetëm një pjesë relativisht e vogël e rasteve përfshijnë informacion të plotë mbi këtë element. Ky fakt është tregues i një praktike problematike në mbledhjen e të dhënave në proceset gjyqësore, që kufizon mundësinë për analizë statistikore të plotë dhe për formulimin e politikave efektive preventive. Mungesa e këtyre të dhënave është një sfidë serioze për sistemin ligjor dhe kërkon forcimin e praktikave të mbledhjes dhe regjistrimit të informacionit në mënyrë të detajuar dhe standardizuar.

Kur përqindjet llogariten mbi rastet me informacion, del se tek viktimat pjesa më e madhe (59%) janë të punësuar, ndërsa një pjesë e konsiderueshme janë pensionistë (24%). Kjo tregon se dhuna nuk është një fenomen që prek vetëm personat me varfëri apo pa punë, por prek edhe ata me status ekonomik dhe social relativisht më të mirë. Ky element e bën më të domosdoshëm zhvillimin e masave mbrojtëse që shkojnë përtej asistencës ekonomike, duke përfshirë edhe mbështetjen psikologjike, juridike dhe sociale për viktimat. Të dhënat që tregojnë se 24% e viktimave të dhunës në familje janë pensionistë ngrenë shqetësime serioze mbi përmasat e këtij fenomeni në raport me moshën e tretë. Kjo përqindje e konsiderueshme evidenton një kategori shpesh të anashkaluar në diskursin publik dhe institucionet mbrojtëse. Pensionistët janë ndër më të pambrojturit përballë dhunës familjare, për shkak të varësisë së tyre ekonomike, gjendjes së dobët shëndetësore, izolimit social dhe mungesës së fuqisë për të kërkuar ndihmë apo për të ndërmarrë veprime ligjore. Dhuna ndaj tyre shpesh vjen nga persona të afërt, si fëmijët apo familjarë të tjerë, duke e bërë situatën edhe më të ndërlikuar, për shkak të lidhjeve emocionale dhe mungesës së alternativave të jetesës.

Një sfidë e madhe është nënraportimi i rasteve, i ndikuar nga ndjenja turpi, frika apo mentaliteti tradicional që e shih dhunën si çështje private. Në shumë raste, dhuna nuk perceptohet qartë as nga vetë viktimat, sidomos kur ajo është e natyrës psikologjike, ekonomike apo neglizhente. Kjo e bën të domosdoshëm përmirësimin e mekanizmave të identifikimit dhe ndërhyrjes, përmes trajnimeve të personelit shëndetësor, social dhe ligjor. Po ashtu, institucionet shtetërore dhe shoqëria civile duhet të ndërtojnë politika të dedikuara për mbrojtjen e të moshuarve, duke përfshirë linja ndihme, strehim emergjent dhe mbështetje psiko-sociale.

Përfshirja e pensionistëve në numrin e lartë të viktimave të dhunës në familje nuk duhet të trajtohet si një pasojë e rastësishme, por si një tregues i nevojës për një qasje më gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj kësaj kategorie. Mbrojtja e dinjitetit dhe sigurisë së të moshuarve kërkon një ndërhyrje të koordinuar mes institucioneve, komunitetit dhe familjes.

Nga ana tjetër, tek dhunuesit pjesa më e madhe (80%) janë të pa punë, gjë që lidh fenomenin e dhunës me mungesën e stabilitetit ekonomik dhe të rolit shoqëror që ka punësimi. Papunësia mund të kontribuojë në ndjenja frustrimi dhe mungesë kontrolli, të cilat shpesh manifestohen në formë të dhunës fizike, psikologjike apo ekonomike ndaj anëtarëve të familjes. Vetëm një pjesë e vogël e dhunuesve janë të punësuar (20%), duke treguar qartë se mungesa e statusit profesional është një faktor risku i rëndësishëm në shfaqjen e dhunës në marrëdhëniet familjare.



Kjo përqindje e ulët e punësimit tek dhunuesit tregon një mungesë të theksuar të integritit ekonomik dhe social, që në literaturën sociale dhe juridike konsiderohet një nga faktorët kryesorë nxitës të dhunës në familje. Papunësia krijon një mjedis të përshtatshëm për tensione dhe konflikte, sidomos kur ndërldhet me faktorë të tjerë stresues si varfëria, mungesa e perspektivave ekonomike dhe ndjenja e mungesës së kontrollit mbi jetën.


Në kuadër të reformave ligjore dhe politike sociale, është thelbësore që përveç masave ligjore mbrojtëse, të krijohen edhe programe të integritit ekonomik dhe social, të cilat mund të kontribuojnë në reduktimin e faktorëve shkaktar të dhunës. Kjo nënkupton bashkëpunim ndër-institucional mes gjyqësorit, shërbimeve sociale dhe agjencive të punësimit për të adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse këtë problematikë.

Përfundimisht, lidhja mes papunësisë dhe dhunës në familje duhet të shihet jo vetëm si një çështje sociale, por edhe si një sfidë juridike dhe politike, që kërkon politika të qarta dhe të efektshme për mbrojtjen e viktimave dhe rehabilitimin e dhunuesve.

III.5 MOSHA MESATARE

Të dhënat e paraqitura mbi moshat mesatare të viktimave dhe dhunuesve, përkatësisht 45vjeç (viktima) dhe 46 vjeç (dhunuesi) ofrojnë një tregues domethënës mbi natyrën dhe dinamikën e dhunës në familje. Afërsia e moshës tregon se shumica e rasteve të dhunës ndodhin në marrëdhënie të qëndrueshme dhe afatgjata, ku partnerët ndajnë jo vetëm hapësira të përbashkëta jetese, por edhe përgjegjësi prindërore, ekonomike dhe emocionale. Kjo sugjeron se dhuna nuk lind si rezultat i një konflikti të rastësishëm, por si produkt i tensioneve të akumuluar, rolit të pabarabartë brenda familjes dhe mungesës së mekanizmave efektivë për

zgjidhjen e konflikteve. Në këtë kontekst, dhuna bëhet pjesë e një strukture të vazhdueshme sjelljesh abuzive, shpesh e fshehur pas normalitetit të jetës familjare.



Kjo prirje ka rëndësi të veçantë për sistemin gjyqësor dhe social, pasi nënkupton se dhuna prek thelbin e unitetit familjar dhe sjell pasoja të gjera që shkojnë përtej individëve të përfshirë. Në shumë raste, viktimat dhe dhunuesit janë prindër të miturve, çka e shndërron dhunën familjare në një problem që cenon zhvillimin emocional, psikologjik dhe social të fëmijëve. Për këtë arsye, trajtimi i rasteve nuk duhet të kufizohet vetëm në ndërhyrjen penale, por të përfshijë edhe masa të orientuara drejt mbështetjes së familjes si njësi shoqërore. Gjykatat, institucionet e mbrojtjes sociale dhe shërbimet psikosociale duhet të bashkëpunojnë ngushtë për të ofruar ndërhyrje që garantojnë sigurinë, stabilitetin emocional dhe rindërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme.

Në këtë grupmoshë, individët janë zakonisht aktivë ekonomikisht dhe nga ana sociale, çka e bën dhunën edhe më problematike, pasi ajo ndikon në produktivitetin, marrëdhëniet shoqërore dhe mundësitë për integrim ekonomik. Prandaj, politikat mbrojtëse duhet të përfshijnë programe të rehabilitimit dhe këshillimit që synojnë jo vetëm ndëshkimin e dhunuesve, por edhe rikthimin e tyre në një jetë sociale dhe profesionale të qëndrueshme. Për viktimat, është thelbësore ofrimi i mbështetjes ligjore, psikologjike dhe ekonomike, në mënyrë që të kenë mundësinë e rimëkëmbjes dhe pavarësisë pas përjetimit të dhunës.

Në kuadër të reformave ligjore dhe politike, duhet theksuar rëndësia e një qasjeje të integruar që i sheh rastet e dhunës jo vetëm përmes prizmit penal, por edhe përmes dimensioneve sociale dhe njerëzore. Masa mbrojtëse më efikase, si programet e rehabilitimit për dhunuesit, këshillimi familjar dhe ndihma për fëmijët e prekur, janë domosdoshmëri për të rikthyer stabilitetin në jetën familjare. Vetëm një qasje e tillë e plotë dhe e koordinuar mund të garantojë që trajtimi i dhunës të mos jetë thjesht ndëshkues, por parandalues dhe shërues, duke kontribuar në ruajtjen e strukturës familjare dhe në forcimin e sigurisë sociale.

III.6 ROLI I GJENDJES FAMILJARE DHE SOCIAL-EKONOMIKE

- 115 viktimat janë të martuara, por gjithsesi ka një numër të konsiderueshëm të të
- divorcuarve (10) dhe beqarëve (35), duke treguar që dhuna nuk kufizohet vetëm në marrëdhëniet bashkëshortore, por ndodh edhe në marrëdhënie të tjera të ngushta.
- Në 140 raste viktimat kanë fëmijë, që tregon për ndikim të thellë mbi mirëqenien familjare dhe nevojën për masa mbrojtëse të integruara.

Roli i gjendjes familjare dhe socio-ekonomike është thelbësor në analizën e rasteve të dhunës në familje. Nga 173 viktimat të përfshira në vendimet e urdhrave të mbrojtjes, 115 prej tyre, pra rreth 66.5%, janë të martuara, duke treguar se shumica e dhunës ndodh brenda marrëdhënieve bashkëshortore. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm prej 10 viktimash (rreth 6%) janë të divorcuar, ndërsa 35 viktimat (rreth 20.5%) janë beqare, çka evidenton se dhuna nuk kufizohet vetëm në kuadrin e martesës, por ndodh edhe në marrëdhënie të tjera të ngushta familjare ose shoqërore.

Në 140 raste, që përbëjnë rreth 81% të viktimave, ato kanë fëmijë, duke nënvizuar ndikimin serioz dhe afatgjatë të dhunës mbi mirëqenien dhe stabilitetin familjar. Kjo evidenton nevojën e domosdoshme për masa mbrojtëse që janë të integruara dhe multidimensionale, duke përfshirë mbrojtjen e viktimave dhe fëmijëve, si dhe mbështetjen sociale dhe ekonomike për familjet e prekura. Ky aspekt kërkon ndërhyrje të koordinuara ndër-institucionale për të garantuar mbrojtjen dhe trajtimin efektiv të rasteve të dhunës në familje. Dhuna ka një ndikim të thellë mbi mirëqenien familjare dhe nënvizon nevojën për masa mbrojtëse dhe strategji integruese që adresojnë jo vetëm viktimat, por edhe fëmijët dhe stabilitetin e tërë familjes.

III.7 TË MITURIT DHE FORMAT E MBROJTJES SË TYRE

Të miturit përbëjnë një nga grupet më të cënueshme në kontekstin e dhunës në familje dhe për këtë arsye ligji i vendos ata në qendër të mbrojtjes gjyqësore dhe institucionale. Gjykata ka të drejtën dhe detyrimin që, kryesisht, në momentin e lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrit të mbrojtjes, të parashikojë masa të posaçme mbrojtëse për fëmijët që kanë qenë viktimat të drejtpërdrejta të dhunës ose kanë qenë të pranishëm në momentin kur dhuna është ushtruar në familje (dhunë e asistuar). Kjo dispozitë përbën një element të rëndësishëm të reformës ligjore në fushën e mbrojtjes së të miturve, pasi i jep përparësi interesit më të lartë të fëmijës në çdo vendimmarrje gjyqësore.

Ligji gjithashtu parashikon masa për eliminimin e pasojave të dhunës ndaj fëmijëve, përfshirë rastet kur dhuna është ushtruar nga prindërit apo kujdestarët ligjorë. Në këto raste, parashikohet mundësia e vendosjes së fëmijës në përkujdesje alternative ose dhënia e masave mbrojtëse emergjente, në përputhje me legjislacionin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Këto masa synojnë jo vetëm sigurimin fizik të fëmijës, por edhe mbështetjen psikologjike dhe sociale për t'i mundësuar atij rikuperimin nga trauma.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm që parashikon ligji lidhet me programet e posaçme për arsimimin dhe rehabilitimin e të miturve, si për ata që janë viktimë, ashtu edhe për ata që janë dhunues. Këto programe, që shtrihen në arsimimin parauniversitar dhe profesional, kanë si qëllim riintegrimin dhe rishoqërimin e të rinjve deri në moshën 21 vjeç, duke ndihmuar në ndërprerjen e ciklit të dhunës dhe në ndërtimin e modeleve të reja të sjelljes.

Megjithëse kuadri ligjor është i qartë në mbrojtjen e të miturve, zbatimi praktik i këtyre dispozitave është ende i kufizuar. Nga vëzhgimi i praktikës gjyqësore rezulton se masa mbrojtëse specifike për fëmijët rrallëherë parashikohen në vendime, edhe në rastet kur të miturit kanë qenë të pranishëm gjatë episodeve të dhunës. Kjo tregon një mungesë të bashkërendimit ndërmjet gjykatave, shërbimeve sociale dhe strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijëve.

Në analizën e 173 vendimeve të gjykatës mbi urdhrat e mbrojtjes, rezulton se në 25 vendime është evidentuar përfshirja e të miturve si pjesë e urdhrave të mbrojtjes, ndërsa gjithsej 28 fëmijë janë marrë në mbrojtje. **PRA VETËM** 14.5% e vendimeve për urdhër mbrojtjeje përfshijnë drejtpërdrejtë të mitur. Ky tregues thekson prekin e drejtpërdrejtë të fëmijëve nga konfliktet familjare dhe dhuna, duke e bërë mbrojtjen e tyre një çështje prioriteti ligjor dhe shoqëror.

Megjithatë, shqetësuese është fakti që vetëm në 8 vendime rezulton përfshirja e profesionistëve të shëndetit mendor, konkretisht psikologëve, gjatë procesit gjyqësor. Kjo e dhënë mund të mos reflektojë domosdoshmërisht mungesën reale të përfshirjes së psikologëve në proceset gjyqësore, por mungesën e dokumentimit të pranisë së tyre në vendimet gjyqësore.

Gjithsesi nëse kjo mungesë qëndron, tregon një zbrazëti kritike në zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, siç përcaktohet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës (Këshilli i Kombeve të Bashkuara, 1989), si dhe në legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e fëmijëve dhe dhunën në familje.

Nga këndvështrimi juridik, përfshirja e profesionistëve të shëndetit mendor është thelbësore për të siguruar një trajtim të plotë dhe multidisiplinar të rasteve që prekin fëmijët, duke mbrojtur jo vetëm integritetin fizik, por edhe shëndetin

psikologjik dhe emocional të tyre. Për më tepër, mungesa e këtij aspekti cenon parimin e interesit më të mirë të fëmijës, i cili duhet të jetë udhërrëfyes kryesor në të gjitha vendimet që prekin të miturit.

Mbrojtja efektive e të miturve në kuadër të urdhërave të mbrojtjes nuk është vetëm një detyrim ligjor, por edhe një element kyç për parandalimin e ndërlikimeve afatgjata sociale dhe psikologjike që dhuna në familje mund të shkaktojë tek brezat e ardhshëm.

Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje³ parashikon qartë që gjykata ka mundësinë dhe përgjegjësinë të marrë masa mbrojtëse për fëmijët që janë viktimë ose janë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje. Sipas ligjit kjo mund të realizohet nëpërmjet urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrit të mbrojtjes, sipas rastit. Kjo dispozitë është në përputhje me parimin ndërkombëtar të interesit më të mirë të fëmijës, të përcaktuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, e cila kërkon që çdo vendim që prek fëmijët të marrë parasysh mbi të gjitha sigurinë dhe mirëqenien e tyre.

Masat mbrojtëse për fëmijët mund të jenë të ndryshme dhe përfshijnë masa që garantojnë largimin nga situata e dhunës, mbrojtje fizike, shërbime mbështetëse psikologjike dhe sociale, si dhe masa që sigurojnë qëndrimin e fëmijëve në një mjedis të sigurt. Ligji u mundëson gjykatave të aplikojnë edhe procedura të tjera që janë parashikuar nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, për aq kohë sa ato nuk cenojnë afatet e procesit gjyqësor të përcaktuara nga ky ligj. Kjo qasje fleksibile është e rëndësishme për të siguruar që masa mbrojtëse të jetë adekuate dhe e përshtatur për rastin konkret, duke respektuar njëkohësisht procedurat ligjore dhe të drejtat e palëve të përfshira.

Ligji parashikon një dispozitë të veçantë lidhur me vendimet për zgjidhjen e martesës që shpallen gjatë kohës së zbatimit të urdhërave të mbrojtjes. Sipas këtij neni, një vendim i tillë për fillimin e zbatimit fillon nga dita e përfundimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrit të mbrojtjes. Kjo qasje siguron që procesi i mbrojtjes së viktimës dhe veçanërisht i fëmijëve, të mos ndërpritet apo cenohet përparësinë e marrjes së masave urgjente për mbrojtje.

Një element i rëndësishëm i këtij neni është parashikimi se, në rast vendosjeje të detyrimeve ushqimore për fëmijët në këto vendime, zbatohet vendimi më i favorshëm për fëmijët. Ky princip është në përputhje me normat ndërkombëtare dhe është një garanci shtesë që fëmijët të mos preken negativisht nga vendime juridike që kanë lidhje me dhunën në familje. Ai reflekton një qasje të integruar të

³ Neni 10 paragrafi 3/1 dhe 3/2

drejtësisë familjare, ku mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është një prioritet kryesor.

Megjithatë, nga analiza e praktikës gjyqësore rezulton se zbatimi i këtyre dispozitave është i kufizuar dhe ndodh vetëm në pak raste. Kjo mungesë përdorimi mund të lidhet me disa faktorë, përfshirë mungesën e vetëdijesimit dhe trajnimit të gjyqtarëve për rëndësinë dhe aplikimin e këtyre dispozitave, mungesën e mekanizmave të përshtatshëm për identifikimin e nevojave specifike të fëmijëve, si dhe një fokus kryesor të procedurave mbi aspektin e urgjencës së mbrojtjes për viktimën e drejtpërdrejtë.

Ky realitet është shqetësues sepse, në përputhje me standardet ndërkombëtare, përfshirja e masave mbrojtëse për fëmijët duhet të jetë pjesë integrale e çdo procesi për dhunë në familje. Refuzimi ose moszbatimi i tyre në praktikë minon efektivitetin e legjislacionit dhe krijon boshllëqe në mbrojtjen e fëmijëve, veçanërisht në situata kur ata kanë qenë dëshmitarë ose viktima të drejtpërdrejta të dhunës.

Nga një këndvështrim juridik, këto dispozita janë të rëndësishme sepse forcojnë mbrojtjen specifike për fëmijët brenda procesit gjyqësor për dhunë në familje. Ato nuk sigurojnë vetëm një mekanizëm për ndërhyrje urgjente, por edhe krijojnë një lidhje mes procedurave për mbrojtje dhe masave që kanë efekt afatgjatë, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe të drejtë për viktimat. Një zbatim i saktë dhe i qëndrueshëm i këtyre dispozitave kërkon sensibilizim të gjyqtarëve dhe forcim të mekanizmave bashkëpunues ndërinstitucionalë për të garantuar mbrojtjen maksimale të fëmijëve në situata të dhunës.

Në këtë kontekst, është e domosdoshme që sistemi gjyqësor të përforcojë praktikën e zbatimit të këtyre dispozitave, duke i dhënë atyre jo vetëm një bazë ligjore, por edhe një përdorim të qëndrueshëm dhe efektiv në shërbim të mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të tyre.

III.8 DHUNA DHE ELEMENTËT E SAJ

Format e dhunës

Forma	Raste	Përqindje
Psikologjike-fizike	91	54%
Vetëm psikologjike	74	43%
Psiko-fizike-ekonomike-seksuale	1	0.5%
Vetëm fizike	1	0.5%

Forma	Raste	Përqindje
Psiko-fizike-ekonomike	1	0.5%
Psikologjike-ekonomike	3	1.5%
Totali	171	100%

Të dhënat e mbledhura për format e dhunës në rastet e trajtuara nga gjykata tregojnë një panoramë të qartë të përmasave dhe natyrës së dhunës që ushtrohet në marrëdhëniet familjare. Format mbizotëruese janë dhuna psikologjike-fizike me 54% dhe dhuna vetëm psikologjike me 43%, ndërsa format e tjera si psikologjike-ekonomike, psiko-fizike-ekonomike-seksuale, vetëm fizike dhe psiko-fizike-ekonomike përbëjnë një përqindje shumë të vogël, rreth 3% në total. Këto shifra tregojnë se dhuna me karakter psikologjik dhe fizik është më e përhapura dhe më e raportuara në praktikën gjyqësore, duke reflektuar një model të qëndrueshëm të sjelljeve abuzive në marrëdhëniet ndërpersonale.

Format e kombinuara të dhunës psikologjike dhe fizike janë tregues i një cikli të dhunës ku agresori përdor presionin emocional për të kontrolluar dhe nënshtruar viktimën, ndërsa dhuna fizike shërben si mjet frikësimi dhe përforcimi i këtij kontrolli. Kjo tregon se në shumicën e rasteve dhuna nuk është një akt i izoluar, por një proces i përsëritur që synon të minojë dinjitetin dhe autonominë e viktimës. Për sistemin gjyqësor, këto raste kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme mbrojtjeje përmes urdhrave të përkohshëm, si dhe mbështetje të vazhdueshme psikosociale për rehabilitimin e viktimave.

Rastet e dhunës vetëm psikologjike përbëjnë pothuajse gjysmën e totalit dhe dëshmojnë për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj formave të padukshme të abuzimit. Këtu përfshihen kërcënimet, poshtërimet, izolimi nga familjarët dhe miqtë, si dhe kontrolli i sjelljeve të përditshme. Dhuna psikologjike shpesh është e vështirë për t'u provuar në gjykatë për shkak të mungesës së provave të drejtpërdrejta fizike, gjë që kërkon përfshirjen e psikologëve dhe punonjësve socialë për të vlerësuar gjendjen emocionale dhe pasojat psiko-sociale të viktimat. Megjithatë, raportimi i lartë i këtij lloji dhune tregon se viktimat kanë filluar ta njohin dhe ta identifikojnë më qartë dhunën psikologjike si formë të vërtetë abuzimi që kërkon ndërhyrje ligjore.

Dhuna psikologjike-ekonomike, edhe pse përbën vetëm 1.5% të rasteve, nënvizon rolin e varësisë financiare si instrument presioni dhe kontrolli ndaj viktimës. Në këto raste, agresori kufizon aksesin në burimet ekonomike, duke e detyruar viktimën të qëndrojë në një marrëdhënie abuzive për shkak të pamundësisë për t'u vetëpërballuar financiarisht. Ky fenomen kërkon ndërhyrje të specializuara, si vlerësim të dëmit ekonomik dhe sigurim të mbështetjes financiare emergjente për viktimat. Raste të tjera më të rralla, si ato të dhunës psiko-fizike-ekonomike-seksuale dhe vetëm fizike, megjithëse të pakta në numër, janë më të rënda në

intensitet dhe shpesh lidhen me trauma afatgjata, duke kërkuar një qasje të integruar nga policia, gjykata dhe shërbimet e rehabilitimit.

Interpretimi i përgjithshëm i të dhënave tregon se dhuna ndaj grave dhe anëtarëve të tjerë të familjes është një fenomen kompleks që shkon përtej agresionit fizik dhe përfshin dimensione psikologjike, sociale dhe ekonomike. Dominimi i dhunës psikologjike në raport me format e tjera nënvizon faktin se shumë marrëdhënie abuzive kanë në themel kontrollin mendor dhe emocional, ndërsa dhuna fizike shfaqet si një pasojë e këtij kontrolli. Për sistemin gjyqësor, kjo nënkupton nevojën për rishikimin e mënyrës se si trajtohen dhe provohen rastet e dhunës, duke u dhënë më shumë peshë ekspertizave psikosociale dhe dëshmimeve.

Në përfundim, analiza tregon se trajtimi efektiv i rasteve të dhunës kërkon një qasje të integruar ligjore dhe sociale. Gjykatat duhet të forcojnë bashkëpunimin me psikologët, punonjësit socialë dhe organizatat që mbështesin viktimat, në mënyrë që proceset gjyqësore të mos mbeten vetëm formale, por të çojnë në mbrojtje reale dhe rehabilitim. Gjithashtu, rekomandohet trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve për të njohur më mirë format e dhunës psikologjike dhe ekonomike, të cilat shpesh nënvlerësohen, si dhe zbatimi i protokolleve të standardizuara për vlerësimin e rrezikut dhe mbrojtjen e menjëhershme të viktimave. Në të njëjtën kohë, forcimi i ndihmës ligjore falas dhe fushatat e ndërgjegjësimit publik do të ndihmonin në identifikimin dhe raportimin më të hershëm të rasteve, duke e bërë luftën kundër dhunës më efektive dhe më të drejtë në nivel gjyqësor dhe shoqëror.

III.9 ELEMENTË PËRNDJEKJEJE DHE DHUNA DIGJITALE

Teknologjia dhe platformat digjitale kanë transformuar mënyrën si njerëzit komunikojnë dhe ndërveprojnë por po ashtu kanë ofruar mjete të reja për kontroll, frikësim dhe abuzim. Përndjekja dhe dhuna digjitale nuk janë vetëm “versione virtuale” të abuzimit fizik, ato kanë karakteristika dhe pasojë të veçanta (p.sh. përhapje shpejtë, ruajtje/ruajtje të provave nga palë të treta, anonimitet, rrezik për ekspozim publiku pa limit kohor) që e bëjnë dhunën më të vazhdueshme, të vështirë për t’u ndaluar dhe shpesh jashtë kuadrit të përgjegjësisë së institucionit lokal. Në kontekstin vendor mungesa e protokolleve të përshtatura, kapaciteteve teknike dhe ndërgjegjësimit publik rrisin rrezikun që këto raste të mbeten të pazbuluara, të patrajuara dhe të pa ndëshkuara.

Gjetja e 10 rasteve me elemente përndjekjeje dhe 15 raste me dhunë digjitale është një tregues i ri dhe shqetësues i modeleve të dhunës që po ndryshojnë me teknologjinë dhe sjelljet bashkëkohore.

Ky fenomen tregon qartë ndryshimet në modelet e dhunës, ku teknologjia dhe platformat digjitale kanë filluar të përdoren gjerësisht. Ky evolucion i dhunës reflekton ndryshimet shoqërore dhe teknologjike që paraqesin sfida të reja për sistemin ligjor dhe institucionet mbrojtëse. Dhuna digjitale dhe përndjekja online shpesh mbeten të panjohura ose nënvlerësuar, dhe për pasojë nuk trajtohen me seriozitetin e duhur në proceset gjyqësore. Përballja me këtë fenomen kërkon miratimin e një kuadri ligjor të posacëm si dhe protokolleve që njohin dhe sanksionojnë këto forma moderne të dhunës, duke u harmonizuar me praktikën më të mira ndërkombëtare. Gjithashtu është thelbësore organizimi i trajnimeve të specializuara për gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë për t'i njohur dhe trajtuar në mënyrë të drejtë këto forma të reja të dhunës. Bashkëpunimi ndërinstitucional mes organeve ligjzbatuese, gjykatave, institucioneve sociale dhe operatorëve të teknologjisë duhet të forcohet për të garantuar mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e rasteve të dhunës në mjedisin digjital. Ky dimension i ri i dhunës kërkon një qasje inovative dhe gjithëpërfshirëse për të adresuar në mënyrë efektive sfidat që paraqet dhuna në familje në epokën moderne.

III.10 SHKAQET E DHUNËS (TË DEKLARUARA)

Shkaku	Raste
Karakter agresiv	161
Pije alkoolike/droga	58
Xhelozia	13
Probleme mendore	7
Konflikte pas divorcit	4
Pronësia	7
Papunësia	2
Lojëra fati, mentaliteti, kafshët	3

Nga 176 raste të analizuar, shkaqet e dhunës janë kategorizuar sipas të dhënave të evidentuara në vendimet gjyqësore. Shkaku më i përmendur është “karakteri agresiv”, i evidentuar në 161 raste, që përbën rreth 91.5% të totalit. Ky përshkrim i përgjithshëm tregon një tendencë për të shmangur vlerësimet më të thelluara psiko-sociale dhe psikologjike të autorëve, duke u bazuar shpesh në një përshkrim të thjeshtëzuar dhe jo gjithmonë të mjaftueshëm për kuptimin e mekanizmave të dhunës.

Përqindja e rasteve ku është konstatuar përdorimi i substancave të tilla si alkooli dhe droga është 33%, me 58 raste, duke treguar se varësitë mund të jenë një faktor

shtytës ose përkeqësues i dhunës. Xhelozia është përmendur në 13 raste, që përbën 7.5% të totalit, duke qenë një shkak emocional që ndikon në konfliktet familjare.

Problemet mendore janë konstatuar në 7 raste, rreth 4%, ndërsa konfliktet pas divorcit dhe ato pronësore përbëjnë përkatësisht 2 % dhe 4% të rasteve. Papunësia është përmendur në vetëm 2 raste (1%), dhe faktorë të tjerë si lojërat e fatit, mentaliteti dhe mospranimi i kafshëve përbëjnë 3 raste të regjistruara (2%).

Në përmbledhje, të dhënat tregojnë se shkaqet e dhunës janë komplekse dhe të shumëfishta, me një dominim të përshkrimit të përgjithshëm “karakter agresiv” që mund të fsheh faktorë më të thellë psikologjikë dhe socialë. Kjo evidenton nevojën për vlerësime më të specializuara dhe përfshirjen e profesionistëve të psikologjisë dhe shëndetit mendor në procesin gjyqësor, për të siguruar një kuptim më të plotë dhe trajtim efektiv të rasteve të dhunës në familje.

Në analizën e shkaqeve të dhunës që përmenden në vendimet e gjykatës mungojnë disa aspekte dhe dimensione thelbësore që do të ishin të domosdoshme për një kuptim më të plotë dhe të thelluar të fenomenit. Këtu nuk përmenden faktorë si varfëria e përgjithshme, pabarazia gjinore, mungesa e arsimit dhe shërbimeve sociale, kultura patriarkale dhe normat shoqërore që mbështesin dhunën si një mënyrë kontrolli. Këto janë faktorë bazë që ndikojnë në shfaqjen dhe përhapjen e dhunës në familje.

Gjithashtu, nuk ka përmendje për ndikimin e traumave të mëparshme, historisë së dhunës në familje, modeleve të trashëguara të dhunës apo abuzimit në fëmijëri, të cilat janë treguar se ndikojnë në ciklin e dhunës. Përveç karakterit agresiv, që është një përshkrim shumë i përgjithshëm, mungon analiza e çrregullimeve të personalitetit, problemeve të shëndetit mendor përveç disa rasteve të deklaruara, streset kronike apo kushtet e tjera psikologjike që mund të ndikojnë në sjellje agresive.

Gjithashtu, mungon një vlerësim serioz psiko-social me përfshirjen e psikologëve, që në rastet e dhunës me viktima të rritur janë shumë të pakta. Faktorët ekonomikë janë përmendur shumë pak, si papunësia, ndërsa në praktikë ky është një faktor i ndërlikuar dhe më i gjerë. Ndikimi i substancave narkotike dhe alkoolit, ndërsa përmendet në disa raste, mungon një analizë më e hollësishme mbi mënyrën se si këto substanca ndikojnë në sjelljen agresive dhe në dinamikën familjare.

Gjithashtu, nuk evidentohen aspekte si izolimi social, varësia emocionale, mungesa e rrjetit mbështetës apo streset e jashtme si papunësia e partnerit ose problemet ligjore.

Në përmbledhje, shkaqet e dhunës janë shumë të përgjithshme dhe shpesh reduktohen në karakteristikat individuale pa hyrë thellë në faktorët socialë,



ekonomikë, psikologjikë dhe institucional. Një analizë më e plotë dhe profesionale do të kërkonte një qasje multidimensionale dhe përfshirjen e ekspertëve të ndryshëm për të kuptuar dhe trajtuar në mënyrë efektive këto shkaqe.

KREU IV

CËSHTJET E RRËZUARA DHE TË PUSHUARA

IV.1 CËSHTJET E RRËZUARA

Nga gjithsej 184 vendime për refuzim ose rrëzim të kërkesave për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes, 171 prej tyre (93%) lidhen me pretendime për dhunë psikologjike, ndërsa 13 raste (7%) për dhunë fizike dhe psikologjike së bashku. Kjo tregon se shumica dërrmuese e rasteve që përfshijnë kërkesa të refuzuara lidhen me dhunën psikologjike, e cila është më sfiduese për t'u provuar ligjërisht.

Arsyet kryesore të refuzimit kanë qenë mungesa e rrezikut real dhe të menjëhershëm për shëndetin apo mirëqenien, si dhe mungesa e provave të mjaftueshme për të provuar veprimet që përbëjnë dhunë. Konkretisht, në 171 raste (93%) gjykata ka konstatuar se pala paditëse nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme, duke bërë që kërkesa të rrëzohet.

Në 6 raste (3.5%) është konstatuar se subjekti i kërkesës nuk ishte nën mbrojtjen ligjore për urdhër mbrojtjeje, duke treguar një numër të vogël të kërkesave të papërputhshme me ligjin. Në 1 rast (0.5%) ku pala e paditur është larguar nga banesa dhe ka deklaruar se nuk do të kthehet më, gjykata ka vendosur se nuk ekziston rreziku i përsëritjes së konfliktit, duke refuzuar urdhërin e mbrojtjes. Edhe në 1 rast (0.5%) ku konflikti ka qenë mbi pronësinë dhe debatet verbale, kërkesa është refuzuar për mungesë të bazës ligjore për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes.

Në 3 raste (1.5%) kërkesat janë tërhequr nga pala paditëse ose nuk është paraqitur fare në seancë, çka ka sjellë refuzimin e tyre.

Nga aspekti i mbështetjes profesionale, psikologu është thirrur vetëm në 5 raste (2.5%), ndërsa avokati ka marrë pjesë në 23 raste (12.5%), që tregon një mungesë të përfshirjes së ekspertëve dhe përfaqësuesve ligjorë në shumicën dërrmuese të rasteve të çështjeve të rrëzuara/refuzuara.

Afatet e shqyrtimit janë respektuar në shumicën e rasteve, duke zgjatur nga 1 deri në 20 ditë, që është në përputhje me nevojën për trajtim urgjent të çështjeve të dhunës në familje.

Përsa i përket përdorimit të instrumenteve ndërkombëtare, në 28 vendime (15.2%) është referuar Konventa e Stambollit dhe KEDNJ, që tregon një përpjekje për harmonizim me standardet ndërkombëtare në trajtimin e këtyre çështjeve.

Një element pozitiv është vendimi i gjykatës në rastet kur kërkesa për urdhër mbrojtje është refuzuar për mungesë prove, por është urdhëruar Njësia e Mbrojtjes

së Fëmijëve pranë Bashkisë Tiranë të monitorojë 3 fëmijët e mitur, duke treguar një qasje proaktive për mbrojtjen e interesave të fëmijëve, edhe kur nuk ka prova të mjaftueshme për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes.

Megjithatë, një problem i evidentuar është mungesa e arsytimit të detajuar në disa vendime, ku përmbajnë vetëm refuzimin për mungesë prove, pa shpjeguar në thellësi rrethanat faktike dhe arsytet ligjore, gjë që cenon transparencën dhe mundësinë e kontrollit gjyqësor efektiv.

Mungesa e arsytimit të detajuar dhe përfshirja e kufizuar e ekspertëve ligjorë dhe psikologjikë janë fusha ku duhet përmirësuar për të garantuar drejtësi efektive dhe transparente.

Në këtë kontekst, rekomandohet përmirësimi i praktikave gjyqësore në aspektin e arsytimit të vendimeve dhe nxitja e përdorimit të ekspertëve për mbështetje në shqyrtimin e kërkesave për urdhër mbrojtje, në përputhje me standardet ligjore dhe ndërkombëtare.

IV.2 ÇËSHTJET E PUSHUARA

Nga 12 çështjet e pushuara të monitoruara, shkaqet e pushimit janë si më poshtë:

- 8 raste (67%) janë pushuar për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse në seancë. Kjo përqindje tregon se dy të tretat e rasteve të pushuara lidhen me mungesën e prezencës së viktimës, e cila është thelbësore për shqyrtimin e kërkesës për urdhrin e mbrojtjes. Mosparaqitja e viktimës kufizon mundësinë e gjykatës për të vlerësuar pretendimet dhe rrezikun, duke çuar në pushim të çështjes.
- 3 raste (25%) janë pushuar sepse pala paditëse nuk ka qenë subjekt i ligjit për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e pushimeve kanë shkaktuar çështje formale që pengojnë vazhdimin e procesit, duke evidentuar nevojën për një verifikim më rigoroz të përmbushjes së kushteve ligjore para fillimit të procedurës.
- 1 rast (8.3%) është pushuar për shkak se paditësja kishte marrë më parë urdhrin e mbrojtjes, dhe në këtë rast kërkesa ishte bërë për vajzën e saj, e cila është në moshë madhore dhe ka të drejtën të kërkojë vetë urdhrin e mbrojtjes.

Këto të dhëna tregojnë se pushimi i çështjeve lidhet kryesisht me mungesën e pjesëmarrjes së viktimave në proces (67%), një faktor që ndikon në pamundësinë e gjykatës për të shqyrtuar pretendimet dhe për të marrë një vendim të drejtë.

Gjithashtu, pushimet për shkak të mosplotësimit të kushteve ligjore (25%) reflektojnë nevojën për të rritur kontrollin fillestar mbi legjitimitetin e palëve për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes, për të shmangur humbjen e kohës dhe burimeve gjyqësore.

Rasti i veçantë i pushimit (8%) tregon rëndësinë e njohjes së drejtave të personave të rritur, duke i dhënë atyre autonominë për të kërkuar masa mbrojtëse për veten e tyre.

Në përmbledhje, pushimi i 12 çështjeve përbën një tregues të respektimit të standardeve ligjore dhe procedurale, por gjithashtu evidenton nevojën për përmirësime në mbështetjen dhe informimin e viktimave për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në proces dhe për të përforcuar kontrollin e gjykatës mbi kompetencat ligjore të palëve kërkuese. Kjo do të kontribuonte në një zbatim më efektiv të urdhrave të mbrojtjes dhe në rritjen e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor.

Ligji parashikon qartë që, edhe në rastet kur pala paditëse (viktima) nuk është e pranishme në seancë, gjykata mund të marrë vendim për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, nëse rreziku për viktimën është i menjëhershëm dhe real. Kjo është një masë që synon të mbrojë viktimat e dhunës në familje, duke shmangur vonesat që mund të krijohen nga mungesa e pjesëmarrjes së tyre, për arsye të ndryshme, si frika, presioni psikologjik apo kërcënimet nga dhunuesi.

Kjo dispozitë ligjore është në harmoni me parimin e mbrojtjes së të drejtave të viktimave dhe tërheq vëmendjen në rolin aktiv të gjykatës në garantimin e sigurisë së tyre, duke vepruar edhe kur viktima nuk mund të marrë pjesë drejtpërdrejt në proces.

Pra, mungesa e pjesëmarrjes së viktimës në seancë nuk duhet të konsiderohet automatikisht si shkak për refuzim ose pushim, por gjykata duhet të shqyrtojë të gjitha rrethanat dhe provat që disponon, për të vendosur në mënyrë që të mbrojë viktimën në mënyrë efikase dhe në përputhje me ligjin.

Në këtë mënyrë, ligji siguron mbrojtje juridike edhe në kushtet kur viktima nuk është në gjendje të përfaqësohet vetë në seancë, duke u garantuar atyre të drejtën për mbrojtje dhe siguri pa pengesa administrative apo procedurale.

KONKLUZIONE

I. Transparenca dhe publiciteti i seancave

1. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë respekton në mënyrë të përgjithshme standardet ligjore dhe ndërkombëtare për zhvillimin e seancave të hapura dhe transparente;
2. Janë vendosur mekanizma për të garantuar pjesëmarrjen e publikut dhe medias, si në mënyrë fizike (në ambientet e gjykatës) ashtu edhe në mënyrë digjitale përmes faqes zyrtare;
3. Aksesit në kalendarin e gjykimeve është i garantuar përmes tabelave elektronike dhe platformës online të gjykatës, duke lehtësuar pjesëmarrjen dhe informimin e qytetarëve;
4. Mungesa e infrastrukturës së mjaftueshme dhe zhvillimi i seancave edhe në zyrat e gjyqtarëve dëmton solemnitetin e procesit gjyqësor dhe ndikon në perceptimin publik për barazi dhe transparencë;
5. Edhe pse ligjërisht është parashikuar regjistrimi audio i seancave, në praktikë kjo zbatohet pjesërisht, për shkak të mungesës së pajisjeve ose kushteve infrastrukturore në zyrat e gjyqtarëve. Në raste të caktuara, mbahet vetëm procesverbal i shkruar;

II. Publikimi dhe anonimizimi i vendimeve

6. Gjykata nuk arrin të publikojë vendimet gjyqësore në mënyrë sistematike në faqen zyrtare, kryesisht për shkak të vështirësive teknike dhe mungesës së burimeve për procesin e anonimizimit;
7. Procesi i anonimizimit është ligjërisht i detyrueshëm, por zbatimi i tij është ende i fragmentuar dhe jo gjithmonë i saktë. Sistemet automatike ekzistuese kanë vështirësi në identifikimin e plotë të të dhënave për shkak të fleksibilitetit të gjuhës shqipe dhe mungesës së standardizimit;

III. E drejta për mbrojtje dhe ndihmë juridike

8. Përqindja e lartë e rrëzimit /refuzimit të kërkesave për urdhër mbrojtjeje (rreth 52%) tregon për vështirësi të mëdha që kanë viktimat për të përmbushur kërkesat ligjore ose për të provuar dhunën. Kjo ngre pikëpyetje mbi qasjen e sistemit gjyqësor ndaj dhunës në familje dhe nivelin e mbrojtjes efektive që ofrohet;
9. Ndihma juridike falas, edhe pse e garantuar me ligj për viktimat e dhunës në familje, në praktikë jepet në një përqindje shumë të ulët (vetëm 22%). Viktimat e dhunës në familje shpesh nuk e marrin ndihmën në kohën e duhur për të përfaqësuar veten në fazat kritike të procesit;

10. Afatet ligjore për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë juridike (deri në 5 ditë) janë më të gjata se afatet për vendimin për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes (24-48 orë). Kjo mospërputhje lë viktimat të pambrojtura ligjërisht në momentin kur më shumë kanë nevojë;
11. E drejta e viktimës për të ankimuar vendimin gjyqësor është e kufizuar, pasi lejohet vetëm kur viktima mendon se masat e dhëna rrezikojnë sigurinë e viktimës. Kjo kufizon aksesin e saj në drejtësi dhe e vendos në pozitë të pafavorshme krahasuar me palën tjetër;
12. Përfundimi i mundësisë për rekurs në Gjykatën e Lartë për rastet e urdhrave të mbrojtjes përbën një pengesë për kontrollin më të lartë juridik, dhe redukton mundësinë për vendosjen e një praktike të unifikuar dhe standarde më të larta mbrojtjeje;

IV. Cilësia e vendimeve dhe arsyetimi gjyqësor

13. Në një pjesë të rasteve, vendimet për urdhrin e mbrojtjes janë të përgjithshme, me formulime standarde, pa analizë të detajuar të fakteve dhe provave të rastit konkret. Kjo praktikë dëmton transparencën dhe cenon të drejtën për një proces të drejtë dhe të arsyetuar;
14. Në 68% të vendimeve të pranuar nuk ka asnjë referencë ndaj instrumenteve ndërkombëtare si Konventa e Stambollit apo KEDNJ;
15. Në 94% të rasteve, vendimi është marrë pa prova konkrete, vetëm mbi bazën e bindjes së gjyqtarit. Vlerësojmë se ky është një mjet i ligjshëm dhe i nevojshëm në rastet urgjente, por mungesa e arsyetimit të kësaj bindjeje mund të krijojë rrezik për arbitraritetin dhe vendime të padrejta;
16. Zbatim minimal i dispozitës që lejon gjykatën të lëshojë urdhrë mbrojtjeje edhe në rast “pajtimi” të palëve. Në praktikë, kjo dispozitë zbatohet shumë rrallë, duke reflektuar një mungesë të theksuar ndërgjegjësimi mbi rrezikun e “pajtimit të detyruar”;
17. Tendencë drejt urdhrave me kohëzgjatje të konsiderueshme. Pjesa dërrmuese e urdhrave të mbrojtjes kanë kohëzgjatje 6-12 muaj (76% e vendimeve). Kjo reflekton një qasje mbrojtëse dhe parandaluese afatgjatë, në përputhje me standardet ndërkombëtare si Konventa e Stambollit. Vetëm 17% e rasteve kanë kohëzgjatje 1-3 muaj, duke treguar se gjykatat i shohin si të pamjaftueshme periudhat shumë të shkurtra për mbrojtjen efektive të viktimës;
18. Masat më të përdorura nga gjykata janë: programe rehabilitimi për dhunuesin (34%) dhe largimi nga banesa (27%). Masa thelbësore si sekuestrimi i armëve, strehimi i viktimës, zbatohen shumë rrallë (<5%);
19. Në vetëm 2.5% të rasteve janë thirrur përfaqësues të Policisë apo koordinatorë vendorë në seanca gjyqësore. Megjithatë ligji e lejon këtë pjesëmarrje, gjykata nuk e zbaton në mënyrë sistematike, duke humbur mundësinë për një vlerësim më të plotë dhe objektiv të situatës së dhunës;

20. Policia, shërbimet sociale dhe prokuroria në shumë raste nuk kanë rol aktiv për të kërkuar urdhëra mbrojtjeje, duke e lënë barrën vetëm mbi viktimën. Kjo sjellë mungesë reagimi në raste të dhunës së përsëritur, ku viktimat mund të jetë e frikësuar ose e paaftë për të kërkuar ndihmë vetë;
21. Afatet ligjore në lidhje me trajtimin e kërkesave për urdhër mbrojtjeje respektohen në një masë të madhe, ku në 96 % të rasteve shqyrtimi gjyqësor fillon dhe përfundon brenda periudhës së parashikuar ligjore, ku mesatarisht shqyrtimi gjyqësor për këto çështje përfundon 12 ditë pas depozitimit të kërkesë-padisë;

V. Aspektet gjinore dhe socio-demografike

21. Dhuna në familje ka dimension gjinor të qartë, ku gratë dhe vajzat janë viktimat kryesore (84%), ndërsa meshkujt dominojnë si dhunues (93%);
22. Rastet janë komplekse dhe përfshijnë shpesh më shumë se një viktimë, duke përfshirë edhe fëmijët dhe anëtarë të tjerë të familjes;
23. Dhuna bashkëshortore është forma më e përhapur, duke përbërë 37% të rasteve, duke reflektuar probleme të thella në marrëdhëniet martesore si varësia ekonomike dhe kontrolli emocional. Një përqindje e rëndësishme, 21%, përfshin marrëdhëniet prind-fëmijë dhe fëmijë-prind, që është shqetësuese për sigurinë e fëmijëve dhe kërkon zbatim më të mirë të ligjit. Dhuna ndodh edhe në marrëdhënie të tjera familjare, si midis motrës dhe vëllait, kunetërve, ish-bashkëshortëve dhe bashkëjetuesve, duke treguar natyrën shumëdimensionale të fenomenit. Fenomeni ka rrënjë kulturore dhe kërkon ndërhyrje të thella sociale dhe komunitare;
24. Viktimat në shumicë kanë arsim të mesëm dhe të lartë (~70%), duke treguar se dhuna prek të gjitha shtresat shoqërore, jo vetëm individët me arsim të ulët;
25. Dhunuesit kryesisht kanë nivel arsimor të ulët (57% me arsim bazë ose fillor), duke sugjeruar lidhje mes mungesës së edukimit dhe predispozitës për dhunë;
26. Mungesa e informacionit të detajuar mbi statusin e punësimit në vendimet gjyqësore është shqetësuese dhe kufizon analizën dhe politikëbërjen efektive;
27. Tek viktimat, 59% janë të punësuar dhe 24% pensioniste, që tregon se dhuna prek edhe persona me status ekonomik relativisht më të mirë dhe të moshuarit;
28. Tek dhunuesit, 80% janë të papunë, duke lidhur papunësinë me rritjen e riskut për sjellje dhunuese në familje;
29. Afërsia në moshë mes viktimës dhe dhunuesit (mesatarisht 45 dhe 46 vjeç) tregon se shumica e rasteve ndodhin në marrëdhënie të qëndrueshme dhe afatgjata, duke përforcuar idenë se dhuna në familje është shpesh një proces i akumuluar dhe jo një akt i izoluar;

30. Gjendja familjare e viktimave, ku rreth 66.5% janë të martuara dhe një pjesë e konsiderueshme janë beqare ose të divorcuara, tregon se dhuna nuk është e kufizuar vetëm brenda martesës, por prek një gamë të gjerë marrëdhëniesh të ngushta;

VI. Fëmijët dhe mbrojtja e tyre

31. Prania e fëmijëve në 81% të rasteve thekson ndikimin e drejtpërdrejtë që dhuna ka mbi fëmijët dhe mirëqenien familjare në tërësi, duke e kthyer këtë fenomen në një çështje me pasoja afatgjata sociale dhe psikologjike;
32. Të miturit janë drejtpërdrejtë të prekur nga dhuna në familje, si viktimë ose dëshmitarë (dhunë e asistuar), por prania e tyre në vendimet për urdhrat e mbrojtjes mbetet e kufizuar. Në vetëm 14.5% të vendimeve është evidentuar përfshirja e fëmijëve në urdhëra mbrojtjeje. Kjo gjetje sugjeron një nënvlerësim të ndikimit të dhunës mbi fëmijët dhe të nevojës për t'i përfshirë ata në masat mbrojtëse;
33. Përfshirja e profesionistëve të shëndetit mendor është jashtëzakonisht e ulët, vetëm në 8 vendime ($\approx 4.6\%$), çka krijon boshllëqe serioze në trajtimin psikosocial të rasteve të dhunës në familje;
34. Mungesa e përfshirjes së masave specifike për fëmijët në vendime reflekton një fokus të ngushtë të sistemit gjyqësor te viktimë e drejtpërdrejtë e dhunës, ndërkohë që neglizhohen pasojat afatgjata që dhuna ka mbi fëmijët si bashkëjetues në mjedisin e dhunshëm;
35. Trajnimi i pamjaftueshëm i gjyqtarëve dhe mungesa e bashkëpunimit ndër-institucional ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe efektivitetin e mbrojtjes së fëmijëve në raste të dhunës në familje;

VII. Format, shkaqet dhe sfidat e provueshmërisë së dhunës

36. Dhuna në marrëdhëniet familjare shfaqet kryesisht në formën psikologjike-fizike (54%) dhe vetëm psikologjike (43%). Kjo tregon se dhuna shpesh është një proces i përsëritur, ku presioni emocional shoqërohet me dhunë fizike për të kontrolluar viktimat. Format e tjera, si dhuna ekonomike apo seksuale, janë më pak të përhapura/raportuara por me intensitet të lartë dhe pasojë afatgjatë;
37. Përqindja e lartë e rasteve vetëm me dhunë psikologjike reflekton rritjen e ndërgjegjësimit për këtë formë të abuzimit që shpesh mbetet e padukshme dhe e vështirë për t'u provuar në gjykatë;
38. Përhapja e teknologjisë ka sjellë forma të reja dhune si përndjekja online dhe dhuna digjitale, të cilat janë sfiduese për t'u identifikuar dhe ndaluar për shkak të karakteristikave të tyre si anonimiteti dhe përhapja e shpejtë. Raste të tilla mbeten shpesh të pazbuluara dhe nënvlerësuar;

39. Shkaku më i shpeshtë i dhunës i pasqyruar në vendimet gjyqësore është përshkrimi i përgjithshëm “karakteri agresiv i dhunuesit” (91.5%), i cili nuk përfshin një analizë të thelluar të faktorëve psikologjikë, socialë apo ekonomikë. Alkooli dhe droga shërbejnë si faktorë përkeqësues, por ndikimi i tyre nuk është analizuar në mënyrë të detajuar nga gjykata. Faktorë të tjerë si varfëria, normat patriarkale, trauma e kaluar dhe mungesa e rrjetit mbështetës nuk janë adresuar si duhet në vendimet gjyqësore;

VIII. Arsyetimi i vendimeve të rrëzuara dhe pjesëmarrja e ekspertëve

41. Shumica (93%) e çështjeve të rrëzuara/refuzuara lidhen me pretendime për dhunë psikologjike, e cila është më sfiduese për t’u provuar ligjërisht. Refuzimet kryesisht bazohen në mungesën e provave të mjaftueshme dhe mungesën e rrezikut real e të menjëhershëm;
42. Në vetëm 2.5% të vendimeve të rrëzuara është përfshirë psikologu dhe në 12.5% avokati, që tregon mungesë të përfshirjes së ekspertëve dhe përfaqësuesve ligjorë në shumicën e rasteve të rrëzuara. Kjo ndikon në cilësinë dhe drejtësinë e vendimeve;
43. Në vetëm 15.2% të vendimeve të rrëzuara është përdorur Konventa e Stambollit dhe KEDNJ, që tregon një përpjekje për harmonizim me standardet ndërkombëtare, por me hapësira për përmirësim;
44. Shumë vendime të rrëzuara përmbajnë vetëm refuzimin për mungesë prove pa argumentim të thelluar, çka cenon transparencën dhe mundësinë e kontrollit gjyqësor;
45. 67% e çështjeve janë pushuar për mosparaqitjen e palës paditëse (viktimës), duke vënë në pah nevojën për mbështetje dhe informim më të mirë të viktimave për të garantuar pjesëmarrjen e tyre. Ligji lejon marrjen e vendimeve për urdhër mbrojtje edhe pa praninë e viktimës në seancë, nëse ka prova të mjaftueshme dhe rrezik të menjëhershëm. Kjo nënvizon rëndësinë e rolit aktiv të gjykatës për mbrojtjen e viktimave, edhe në mungesë të pjesëmarrjes së tyre. Kjo dispozitë aplikohet në mënyrë mjaft të kufizuar. Pushimet për mungesë të kushteve ligjore për legjitimim (25%) tregojnë nevojën për kontroll më rigoroz në fillim të procesit;

REKOMANDIME

I. Transparenca dhe publiciteti i seancave

1. Përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore. Të garantohet që të gjitha seancat të zhvillohen në sallat përkatëse të gjykimit, duke shmangur praktikën e zhvillimit të tyre në zyrat e gjyqtarëve, për të ruajtur solemnitetin dhe barazinë para ligjit;
2. Zgjerimi i aksesit në informacion. Të zhvillohen më tej sistemet elektronike të informacionit në gjykata, duke përfshirë integrimin më të mirë të kalendarëve gjyqësorë, listave të çështjeve dhe dokumenteve procedurale në një platformë të unifikuar;
3. Rritja e ndërgjegjësimit publik. Të zhvillohen fushata të informimit dhe udhëzime publike që shpjegojnë të drejtat e qytetarëve për pjesëmarrje dhe akses në informacionin gjyqësor;

II. Publikimi dhe anonimizimi i vendimeve

4. Digjitalizimi i arkivave gjyqësore. Të përshpejtohet procesi i krijimit dhe funksionalizimit të arkivave elektronike, me synim garantimin e aksesit në vendime dhe dokumente gjyqësore për publikun dhe profesionistët e drejtësisë;
5. Automatizimi dhe përmirësimi i procesit të anonimizimit. Të investohet në teknologji të reja, përfshirë përdorimin e inteligjencës artificiale për anonimizimin automatik të vendimeve. Gjithashtu, të sigurohet që programet të njohin format e ndryshme gjuhësore të të dhënave që duhen anonimizuar;
6. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore. Të rritet numri i specialistëve të trajnuar për anonimizim dhe publikim të vendimeve;
7. Rritja e transparencës në publikimin e vendimeve. Të miratohen objektiva konkrete dhe afate të matshme për publikimin sistematik të vendimeve gjyqësore në faqet zyrtare dhe në portalin kombëtar të vendimeve, pas anonimizimit;

III. E drejta për mbrojtje dhe ndihmë juridike

8. Rishikimi i afateve për ndihmën juridike falas. Afati për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë juridike duhet të harmonizohet me afatet për vendimet gjyqësore për urdhërat e mbrojtjes, në mënyrë që viktimat të mund të kenë përfaqësim ligjor në momentin e paraqitjes së kërkesës;
9. Zgjerimi i aksesit në ndihmën juridike falas. Shteti të sigurojë automatikisht ndihmë juridike për çdo viktimitë që kërkon urdhër mbrojtjeje, pa pritur miratim formal, duke vendosur mekanizma të shpejtë të reagimit për raste të dhunës në familje;

10. Rishikimi i dispozitave për të drejtën e ankimit. Ligji duhet të lejojë ankimin edhe nga viktimat pa asnjë kufizim. Kjo do të rriste aksesin real në drejtësi;
11. Rivendosja e mundësisë për rekurs në Gjykatën e Lartë. Kjo do të krijonte precedentë gjyqësorë të rëndësishëm dhe do të ndihmonte në standardizimin e praktikës gjyqësore për urdhrat e mbrojtjes, duke i dhënë më shumë siguri viktimave;

IV. Cilësia e vendimeve dhe arsyetimi gjyqësor

12. Kryerja e arsyetimit të plotë dhe të personalizuar të vendimeve gjyqësore me qëllim rekspektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor;
13. Përfshirja e legjislacionit ndërkombëtar në vendimet gjyqësore;
14. Zbatimi i dispozitave që lejojnë gjykimin edhe në mungesë të palëve. Gjykatat duhet të aplikojnë në praktikë mundësinë për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes edhe kur viktimat mungon, nëse ekziston rrezik real dhe i menjëhershëm, duke mbrojtur viktimat nga vonesat ose pengesat administrative;
15. Aktivizimi i rolit të policisë dhe prokurorisë për të paraqitur kërkesë për urdhër mbrojtjeje në emër të viktimës në gjykatë;
16. Zbatim i dispozitës që lejon gjykatën të lëshojë urdhër edhe në rast të heqjes dorë të viktimës ose në rast “pajtimit” të palëve;
17. Standardizim i arsyetimit për kohëzgjatjen e urdhërave të mbrojtjes. Kjo do të sigurojë proporcionalitet, ligjshmëri dhe transparencë;
18. Forcimi i përdorimit të masave mbrojtëse. Zbatimi i detyrueshëm i programeve të mbështetjes sociale, psikologjike dhe ekonomike për viktimat, si pjesë e masave të integruara mbrojtëse. Zbatimi i masave si sekuestrimi i armëve, dhe masa mbrojtëse për të miturit duhet të shtohen;
19. Rritja e pjesëmarrjes së institucioneve në proces. Gjykatat duhet të zbatojnë në mënyrë aktive nenin 13, pika 8 të ligjit të dhunës në familje, duke thirrur përfaqësues të policisë dhe koordinatorë vendorë në seanca gjyqësore. Kjo sjell pasurim të provave, rritje të sigurisë së viktimës dhe kontroll më të mirë mbi masat e vendosura;
20. Monitorim dhe trajnime të vazhdueshme. Të realizohet monitorim periodik i praktikës gjyqësore, për lëshimin e urdhërave të mbrojtjes;

V. Aspektet gjinore dhe socio-demografike

21. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve ligjzbatuese dhe gjyqësore për trajtim të ndjeshëm gjinor dhe mbrojtje efektive të viktimave;
22. Hartim i politikave gjithëpërfshirëse për mbështetje të viktimave, duke përfshirë meshkujt si viktimat dhe gratë si dhunuese;
23. Sigurim i shërbimeve të dedikuara për të gjitha viktimat pavarësisht gjinisë, përfshirë mbrojtjen psikologjike dhe sociale;

24. Ndërgjegjësim komunitar dhe fushata sensibilizuese për ndryshimin e normave dhe praktikave kulturore që nxisin dhunën në familje;
25. Hartimi i politikave që adresojnë nevojat specifike socio-ekonomike dhe arsimore të dhunuesve dhe viktimave;
26. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional për ofrimin e mbështetjes juridike, sociale dhe psikologjike për viktimat;
27. Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave të rregullta mbi dhunën në familje për të informuar politikëbërjen dhe për të ndjekur efektivitetin e ndërhyrjeve;

VI. Fëmijët dhe mbrojtja e tyre

27. Fokusim i veçantë te fëmijët e prekur nga dhuna, përmes programeve të këshillimit psikologjik dhe mbështetjes në arsim e zhvillim social, për të minimizuar pasojat afatgjata të përjetimit të dhunës;
28. Standardizimi i përfshirjes së masave mbrojtëse për të miturit në çdo vendim gjyqësor për dhunë në familje, sidomos kur fëmijët janë të pranishëm gjatë incidenteve të dhunës, për të garantuar mbrojtjen e tyre fizike, emocionale dhe psikologjike;
29. Trajnime të specializuara për gjyqtarët, prokurorët dhe punonjësit socialë për të rritur kapacitetet në identifikimin e nevojave të fëmijëve dhe zbatimin e dispozitave që garantojnë interesin më të mirë të fëmijës;
30. Dokumentimi dhe raportimi i detajuar në vendimet gjyqësore i përfshirjes së fëmijëve, masave mbrojtëse të marra dhe pranisë së ekspertëve, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të mundësuar analiza të vazhdueshme për përmirësim;
31. Zbatimi aktiv i programeve rehabilituese dhe edukative për të miturit viktimë apo dhunues, duke e parë riintegrimin social dhe ndërprerjen e ciklit të dhunës si pjesë thelbësore të mbrojtjes afatgjatë;

VII. Format, shkaqet dhe sfidat e provueshmërisë së dhunës

33. Gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët duhet të trajnohen për njohjen dhe trajtimin e formave të ndryshme të dhunës, veçanërisht asaj digjitale;
34. Zhvillimi i protokolleve dhe kapaciteteve teknike për dhunën digjitale. Duhet miratuar protokolle ligjore të posaçme për trajtimin e përndjekjes dhe dhunës digjitale, të harmonizuara me praktikën ndërkombëtare, dhe të zhvillohen kapacitete teknike për zbulimin dhe ndalimin e këtyre formave të reja të abuzimit;
35. Fushata ndërgjegjësimi publik. Organizimi i fushatave që të rrisin ndërgjegjësimin për format e ndryshme të dhunës, me fokus dhunën digjitale, duke inkurajuar raportimin e rasteve në mënyrë më të hershme;

- 36. Qasje multidimensionale në trajtimin e shkaqeve. Në vendimet gjyqësore dhe trajtimin e rasteve duhet të përfshihen analiza të thelluara psiko-sociale, që adresojnë faktorë si trauma e kaluar, varfëria, normat shoqërore dhe faktorët ekonomikë, në mënyrë që të kuptohet më mirë kompleksiteti i fenomenit;
- 37. Përmirësimi i arsytimit të vendimeve. Gjykatat duhet të sigurojnë një arsyetim të detajuar dhe transparent jo vetëm për çështjet e pranuar por edhe për refuzimet ose rrëzimet e urdhërave të mbrojtjes, duke shpjeguar rrethanat e faktit dhe bazën ligjore, për të garantuar drejtësi efektive dhe kontroll gjyqësor;

VIII. Arsyetimi i vendimeve të rrëzuara dhe pjesëmarrja e ekspertëve

- 38. Rritje e përfshirjes së ekspertëve dhe avokatëve, duke ofruar ndihmë juridike dhe profesionale për viktimat;
- 39. Zbatim i standardeve ndërkombëtare, përdorim i rregullt i Konventës së Stambollit dhe KEDNJ-së;
- 40. Arsyetim më i plotë i vendimeve gjyqësore me qëllim rritjen e transparencës dhe kontrollit gjyqësor;

LITERATURA:

Legjislacioni:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
3. Ligji Nr. 9062 datë 08.05.2003 “Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
4. Ligji Nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
5. Ligji Nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, i ndryshuar;
6. Ligji Nr. 104/2012, datë 08.11.2012 “Konventa e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”;
7. Ligji nr.111/2017 datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
8. Udhëzim nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”;
9. Udhëzim nr.912 datë 27.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e Urdhërit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme”;

Studime:

1. Transparenca e gjykatave, Guidë monitorimi për shoqërinë civile, Institutit për Studimet Publike & Ligjore (ISPL), 2023;
2. Aksesit në drejtësi dhe gjykimi i drejtë, Guidë monitorimi për shoqërinë civile, Institutit për Studimet Publike & Ligjore (ISPL), 2023;
3. Integriteti gjyqësor, Guidë monitorimi për shoqërinë civile, Institutit për Studimet Publike & Ligjore (ISPL), 2023;
4. Monitorimi i transparencës së gjykatave manual trajnimi për shoqërinë civile, Institutit për Studimet Publike & Ligjore (ISPL), 2023;
5. Monitorimi i aksesit në drejtësi dhe performanca gjyqësore për zhvillimin e një gjykimi të drejtë, manual trajnimi për shoqërinë civile, Institutit për Studimet Publike & Ligjore (ISPL), 2023;
6. Udhëzime për Qasjen Gjinore në Gjykimin e Rasteve të Dhunës Gjinore, Konul Derya Gasimova;
7. Material burimor Për Prokurorët dhe Gjyqtarët në luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Kosovë, Dhjetor 2020;

8. Mental disorders and intimate partner violence perpetrated by men towards women: A Swedish population-based longitudinal study, Department of Psychiatry, University of Oxford, Oxford, United Kingdom, 2019;
9. Domestic violence: the potential role of job loss and unemployment” CAGE Policy Briefing no. 34, CAGE Research Centre, University of Warwick, October 2021;
10. Udhëzues mbi nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, E drejta për një proces të rregullt (aspekti civil), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
11. Manuallet e të drejtave të njeriut, nr.3, Këshilli i Evropës;



